

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



MËSIME NGA MENDIMI I IMAM KHAMENEIT

2

*(Uniteti, dija, drejtësia shoqëre, rinia, liria, shpresa, durimi
dhe suktesi)*

Tiranë, 2025

**Titulli: MËSIME NGA MENDIMI I IMAM
KHAMENEIT 2**

(Uniteti, dija, drejtësia shoqëre, rinia, liria, shpresa, durimi dhe suksemi)

**Përgatitur nga: Qendra e Njohurive për Hartim dhe
Hulumtim**

Përktheu nga arabishtja: Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Redaktoi: Jerida KULLA

Korrekttoi: Ma. Isra MERJA

Përgatiti për shtyp & Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata “Flladi” - Tiranë, 2025

بسم الله الرحمن الرحيم

Parathënie

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! Paqja e bekimi qoftë mbi më të nderuarin nga krijesat e Tij, Muhamedin dhe familjen e tij të pastër!

Islami përbën një sistem të plotë për jetën, në të gjitha dimensionet dhe kërkesat e tij, duke synuar ndërtimin e shoqërisë njerëzore, shembullore dhe të përsosur, që arrin shkallët më të larta të zhvillimit. Prandaj, thirrja për njeriun është që të njohë vetveten dhe botën, ngaqë kjo njohje ka ndikim në të gjitha aspektet e jetës së tij, dhe si pasojë ndërtohet një sistem i shëndoshë njohjeje, në dritën e mësimeve të Islamit, i mbështetur në Kur'an dhe në Sunetin e ndritur profetik; sepse sistemi mendimor i njeriut është themeli dhe mbështetja ku kthehen veprat dhe qëndrimet e tij.

Njeriu i shëndoshë, kur e kupton mangësinë e vet, lëviz për të kërkuar atë që e plotëson dhe e ngre shpirtërisht. Ndjenja e padijes dhe e kufizimit, tek ai lind një shtytje drejt dijes, sepse ajo ka një rol themelor në përcaktimin e personalitetit dhe sjelljes së tij. Prej këtej, njeriu është kërkuar i të vërtetës në të gjitha çështjet e tij.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka dhënë kontribute shkencore në shumë fusha të dijes, të cilat kanë lënë gjurmë të thella në shpirtrat, mendjet dhe shoqërinë islame në përgjithësi.

Për këtë arsye, shoqata “Flladi”, në bashkëpunim me “Qendrën e Njohurive për Hartim dhe Studim”, me qendër në Bejrut, ka përgatitur librin e dytë, me titull: “Mësime nga mendimi i Imam Khameneit”.

Ky libër shpjegon vizionin e Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), lidhur me tema të rëndësishme jetësore, si: uniteti, rinia, drejtësia shoqërore, dija, liria, shpresa dhe durimi.

Shpresojmë që Allahu të na japë sukses për botime të tjera në këtë fushë, që i shërbejnë qëllimit të synuar.

UNITETI ISLAM

Hyrje

Asnjë shoqëri apo qytetërim nuk mund të qëndrojë i qëndrueshëm pa një identitet mendimor që shpreh vetveten. Përmes këtij identiteti, ajo nis të shfaqet para qytetërimeve të tjera, duke shpallur personalitetin e saj. Kjo nuk mund të ndodhë veçse përmes bashkimit të saj mbi një bazë të fortë, që përfaqëson unitetin e saj. Përçarja dhe copëtimi qytetërues është, në fakt, një shprehje tjetër e zhdukjes së identitetit dhe më pas, e zhdukjes së qytetërimit.

Prej këtui, vlera e unitetit ndërmjet individëve të një qytetërimi të vetëm konsiderohet si një nga themelet më të rëndësishme për ndërtimin e vlerave dhe për këtë arsye, përpjekjet e armiqve të qytetërimit janë të përqendruara, në radhë të parë, në shpërbërjen e lidhjes ndërmjet grupeve, sekteve dhe individëve të një qytetërimi dhe kombi të vetëm.

Në këtë kontekst, del në pah vlera e unitetit islamik, për të cilën Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Pikat e përbashkëta ndërmjet myslimanëve janë më të shumta se pikat e ndarjes dhe dallimeve. Një tjetër pikë është kjo: Nëse

vendosim që të paraqesim vlerat islame si vlera thelbësore në botë, që tërheqin zemrat e njerëzve dhe në bazë të tyre të ndodhë një ndryshim i caktuar në jetën e myslimanëve, atëherë duhet të ruajmë unitetin midis myslimanëve. Në kushte ndarjeje, armiqësie dhe luftërash sektare, myslimanët nuk mund të gëzojnë unitet.

Ne nuk u rekomandojmë grupeve të botës islame të braktisin besimet e tyre dhe të përqafojnë besimet e ndonjë grupi tjetër. Por u themi të gjithë myslimanëve: Hapësirat e përbashkëta ndërmjet nesh janë më të mëdha dhe më të rëndësishme se zonat e ndryshimit. Armiqët tanë e theksojnë gjithnjë ndryshimin, ndërsa ne, përkundrazi, duhet të forcojmë të përbashkëtat dhe të mos i japim armikut asnjë shkas përmes përçarjes sonë, që ai të gjejë zona presioni në trupin e umetit islam”,¹

Kuptimi i unitetit islam

Nëse dëshirojmë të kërkojmë për gjënë e përbashkët që bashkon myslimanët, atë që shprehet si uniteti islam, në radhë të parë, mund të hasim në dallime midis sekteve dhe mendimeve të tyre. Prandaj, pajtimi mes sekteve nuk mund të jetë themeli për arritjen e unitetit. Siç thuhet: “Nuk synohet që të gjitha medh’hebet të shkrihen në një të vetme.

1 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 25.06.1989.

Disa i mohojnë medh'hebet, me qëllim që të arrihet uniteti mes myslimanëve. Por mohimi i medh'hebeve nuk zgjidh problemin. Pranimi i tyre është ajo që e zgjidh. Çdo medh'heb jo vetëm që të veprojë në mënyrë natyrale në zonën e tij, por dhe të përmirësojë marrëdhënien me njëritjetrit".²

Me unitet islam nuk nënkuptojmë që myslimanët të braktisin medh'hebet e tyre dhe të përqafojnë një tjetër. Jo, nuk është kjo që kërkohet. Kur thërrasim për unitet, nuk kemi për qëllim që grupet islame, qofshin shi'ite apo sunitë, ose nënndarjet brenda tyre, të detyrohen të heqin dorë nga besimet e tyre, për t'u bërë pjesë e një pale tjetër. Kjo është çështje që lidhet me kërkimin personal të individit, me kërkimin dhe bindjen e tij para Zotit – dhe nuk është tema jonë.

Ne duam t'u themi të gjithë myslimanëve, si shi'itë, ashtu edhe suni, që mes tyre ka pika të përbashkëta dhe dallime. Ata ndajnë shumë çështje, që i mendojnë dhe i zbatojnë njësoj, dhe kanë edhe gjëra të tjera që i ndjekin ndryshe.

Çështja themelore është kjo: Pikat e përbashkëta janë më të shumta se ato të ndryshimit. Të gjithë myslimanët

2 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 01.05.1376, sipas kalendarit iranian (21 korrik 1997).

besojnë në një Zot të vetëm, një Kibël të vetme, një Profet, në dispozitat fetare, si: namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi.

Nuk gjeni dy myslimanë që nuk ngrihen për të falur namazin e sabahut, vetëm nëse ndokush nuk dëshiron ta kryejë detyrimin e tij. Përndryshe, të gjithë myslimanët e botës besojnë në detyrimin e faljes së pesë kohëve të namazit dhe është e pëlqyeshme që namazi i natës të falet pas mesnatës. Të gjithë myslimanët besojnë se namazi duhet të falet drejt Kiblës dhe në gjuhën e Kur'anit.

Kur vjen muaji i Ramazanit, të gjithë myslimanët agjërojnë, nëse janë të sigurt se ka hyrë dita e parë e Ramazanit, përveç atyre që nuk duan t'i binden detyrimit të tyre. Përndryshe, të gjithë e besojnë këtë çështje...

Ne themi: O myslimanë të botës, kudo që të jeni, nëse njihni armiqtë tuaj dhe miqtë tuaj, realiteti i jetës suaj do të ndryshojë prej asaj që është sot. Ju sot vuani nga përçarja, dobësia dhe prapambetja. Vendet islame janë të varfra, të nënshtruara dhe shpesh të robëruara. Armiqtë e Islamit duan ta zhdukin me forcë Islamin nga vendet islame. Zemrat e të gjithë myslimanëve janë me Zotin dhe Islamin. Ata e duan Islamin. Politikat dhe fuqitë e mëdha botërore përpiqen, përmes qeverive të tyre kukulla, t'i largojnë popujt nga Islami.

Nëse qëndroni së bashku dhe i lini mënjatë mosmarrëveshjet e grindjet, dhe nuk i përdorni fuqitë tuaja, të cilat janë një forcë e madhe që mund të shfrytëzohet për përmirësimin e fesë dhe jetës suaj – kundër njëri-tjetrit, atëherë synimet e ndyra të armiqve nuk do të realizohen.

Le të bashkohen myslimanët dhe të mos jenë armiq mes tyre. Ne nuk po themi që sunitë të kalojnë në Shi'izëm apo shi'itët të heqin dorë nga bindjet e tyre. Natyrisht, nëse ndonjë suni ose kushdo tjetër studion dhe kërkon, atëherë ai duhet të veprojë sipas bindjes që ka arritur, çfarëdo që të jetë ajo bindje. Kjo i përket atij dhe Zotit.

Fjala jonë gjatë “Javës së unitetit” dhe si një mesazh për unitetin, është që myslimanët të bashkohen dhe të mos jenë armiq mes tyre. Baza e këtij uniteti është Libri i Zotit, Suneti i Profetit të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) dhe sheriatu islam. Kjo nuk është një fjalë e keqe. Kjo është një fjalë me të cilën pajtohet çdo njeri i arsyeshëm, i drejtë dhe qëllimshëm”.³

Pra, del qartë se e vërteta e unitetit, që duhet të përbëjë sistemin e përbashkët mes individëve të shoqërisë dhe umetit islam, është bashkimi i forcave, pavarësisht dallimeve të sekteve apo medh'hebeve, për ringritjen qytetëruese të umetit dhe përballjen me armikun, që kërkon

3 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 11.10.1989.

ta zbrazë trupin dhe shpirtin e umetit nga forcat dhe burimet e tij.

Me fjalë të tjera: “Ne, me këtë fjalë, nuk duam të themi që shi’itët të bëhen suni apo sunitë të bëhen shi’itë dhe as të ndalojmë shi’itët dhe sunitë të punojnë shkencërisht për të forcuar bindjet e tyre, sipas mundësive. Përkundrazi, puna shkencore është shumë e mirë dhe nuk ka asnjë problem. Le të shkruajnë libra në mjedise shkencore, jo në mjedise joserioze e me metoda të këqija dhe të gabuara.

Nëse dikush mund të provojë logjikën e tij, atëherë nuk duhet t’ia pengojmë punën... Nëse umeti islam bashkohet në çështjet kryesore, me një popullsi që arrin në një miliard e gjysmë, shihni çfarë fuqie e madhe do të shfaqet në botë. Por, nëse prishet uniteti kombëtar, atëherë të flasësh për unitetin e botës islame, do të duket si një përrallë, për të cilën të gjithë do të qeshin. Disa duan pikërisht ta përhapin këtë gjendje”.⁴

Uniteti islam përballë komplotit të armikut

Pasi armiqtë e Islamit panë se çfarë përmban Islami dhe vendet islame, nga burime dhe potenciale të mëdha, u

4 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 26.03.2000.

ngritën për të penguar krijimin e një bashkësie njerëzore qytetëruese, që përfaqëson fuqinë hyjnore të Islamit dhe qëndrueshmërinë e tij. Prandaj, ata përdorën të gjitha llojet e armëve, për të parandaluar bashkimin e myslimanëve.

Në historinë tonë të sotme, armiku dallon me veçori që nuk kanë ekzistuar më parë: “Ai është i pajisur deri në maksimum me pasuri, politikë, media dhe të gjitha llojet e mjeteve të ndikimit, depërtimit dhe goditjes. Kush është armiku i Islamit? Ai është fronti i arrogancës botërore, që nga Sionizmi, deri tek Amerika, kompanitë e naftës, e deri te shkrimtarët dhe intelektualët e paguar që punojnë për ta.

Ky është një front i armatosur deri në dhëmbë, që shtrihet nga një skaj i botës në tjetrin. Asnjëherë më parë fronti kundër Islamit nuk ka qenë i armatosur dhe i pajisur me kaq shumë mjete dhe mjete ndikimi siç është sot...

Çfarë do të bëjë ky armik? Mjeti më i mirë që ai ka në dorë, është të mbjellë përçarje mes myslimanëve, veçanërisht midis pjesëve që kanë aftësinë të frymëzojnë pjesën tjetër të myslimanëve dhe të jenë shembull për ta”.⁵

5 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 15.08.1995.

Uniteti islam nuk është një parullë boshe

Disa e paraqesin unitetin islam si një parullë politike boshe, pa thelb, por, në realitet, kjo është larg të vërtetës. Mjafton të ndalemi në thellësinë qytetëruese të Islamit dhe në nevojën urgjente për të ndërtuar një qytetërim islam, dhe në atë që kërkon ky ndërtim nga bashkëpunimi i vërtetë dhe real midis myslimanëve, për të kuptuar se parulla e unitetit bazohet në themele të vërteta.

Rekomandimi im për vëllezërit myslimanë është se uniteti midis myslimanëve është një domosdoshmëri jetike për ta, në kohën e tanishme. Nuk është shaka apo vetëm një parullë. Shoqëritë islame duhet të jetojnë së bashku në një gjendje të unitetit të fjalës, në mënyrë të drejtë, të ecin e të lëvizin në mënyrë të koordinuar.

Uniteti, natyrisht, është një çështje e ndërlikuar. Krijimi i unitetit, gjithashtu, është një proces i ndërlikuar. Uniteti midis popujve myslimanë është i mundur, edhe me ekzistencën e dallimeve në shkolla të mendimit, në mënyrat dhe traditat e jetës apo në mendimet juridike. Kuptimi i unitetit midis popujve myslimanë është që ata të lëvizin në një drejtim të përbashkët në çështjet që kanë të bëjnë me botën islame, të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të mos e përdorin potencialin dhe burimet e tyre kundër njëri-tjetrit...

Çështja e unitetit midis myslimanëve është një çështje serioze dhe duhet të trajtohet me seriozitet. Çdo ditë që vonohet realizimi i kësaj çështjeje, është një ditë e humbur për botën islame. Disa nga këto ditë janë aq të ndjeshme, sa ndikojnë në një epokë të tërë. Nuk duhet të lejoni që kjo çështje të vonohet.⁶

Revolucioni në Iran është një revolucion islam, jo një revolucion shi'it

Që nga fillimi i revolucionit, Imam Khomeini (*Zoti e mëshiroftë!*) dhe pas tij, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*), theksuan vazhdimisht se thelbi i këtij revolucion buron nga parimet dhe themelet islame, mbi të cilat duhet të ngrihet çdo qytetërim islam. Prandaj, armiqtë e revolucionit, në përpjekjen e tyre për të shkatërruar themelet e tij, kanë synuar mbjelljen e përçarjes, gjë që çon në largimin e pjesës tjetër të sekteve nga revolucioni islamik. Armiku dëshiron që, pikërisht gjatë Javës së unitetit, që është për unitetin e umetit islam, të shpërthejë përçarje mes sekteve islame.

Veçanërisht pas fitores së Revolucionit Islamik, armiku kërkoi ta shkëpusë Iranin e revolucionit nga pjesa tjetër e popujve. Ai dëshiron që në botën islame të thuhet:

6 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 15.08.1995.

‘Këta janë shi’itë dhe revolucioni i tyre është shi’it, nuk ka të bëjë me ne që jemi suni.

Populli iranian, që nga fillimi i revolucionit, tha: “Po, ne jemi shi’itë, që ndjekim Ehli Bejtin e Profetit, por ky revolucion është një revolucion islam, i ngritur mbi bazën e Kur’anit, teuhidit dhe Islamit të pastër, si dhe mbi bazën e unitetit dhe vëllazërisë mes të gjithë myslimanëve’. Këtë e ka thënë populli ynë, që në fillim dhe e ka shpallur Imami ynë. Mos lejoni që ky unitet të njolloset”.⁷

Qendra bashkuese e myslimanëve

Nëse dëshirojmë të kërkojmë për qendrën që bashkon myslimanët dhe realizon unitetin e tyre, përveç parimeve të përbashkëta të besimit, ku në krye qëndron teuhidi (besimi në Një Zot), do të gjejmë personalitetin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*). Personaliteti i tij është i shenjtë për të gjithë myslimanët dhe përbën një pikë të përbashkët, për të cilën nuk ka mosmarrëveshje mes tyre.

7 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 27.09.1991.

Në këtë drejtim, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Ajo që është e rëndësishme për ne myslimanët, është të shtojmë njohurinë tonë për Islamit dhe për Profetin e nderuar. Një nga tragjeditë më të mëdha të botës islame sot është tragjedia e përçarjes dhe ndarjeve. Personaliteti i shenjtë i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) mund të jetë boshti i unitetit në botën islame, ai është bindje për të gjithë dhe qendra ku bashkohen ndjenjat e të gjithë njerëzve.

Ne, myslimanët, nuk kemi një qendër më të qartë dhe gjithëpërfshirëse se personaliteti i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*); një personalitet në të cilin besojnë myslimanët dhe zemrat e tyre i drejtohen me ndjenja shpirtërore dhe emocionale. Kjo është qendra më e mirë për unitet. Është detyra e dijetarëve të Islamit, intelektualëve myslimanë, shkrimtarëve, poetëve dhe artistëve në botën islame që të paraqesin për myslimanët dhe jomyslimanët personalitetin e Profetit të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) dhe madhështinë e tij, sipas mundësive të tyre. Kjo është diçka që do të ndihmojë në bashkimin e umetit islam dhe në ringjalljen dhe entuziazmin drejt Islamit, gjë që vërehet sot te brezat e rinj të umetit islam”.⁸

8 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 21.06.2000

Prej këtij parimi, Imam Khomeini (*Zoti e mëshiroftë!*) e shpalli ditëlindjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) si një moment për të përhapur vlerën e unitetit islam, përmes idesë së “Javës së unitetit”. Ishte një hap shumë i zgjuar përballë planeve të armiqve dhe, siç shprehet Imam Khamenei, kjo është një “sadaka e vazhdueshme”: “Një nga sadakatë e vazhdueshme të revolucionit, që lindi nga mendimi i vetëdijshëm i Imam Khomeinit (*Zoti e mëshiroftë!*), është shpallja e ditëve të lindjes së Profetit të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) si ditë të unitetit islam. Kjo çështje është e rëndësishme, sepse uniteti islam është një ndër synimet dhe shpresat. Disa e mbajnë vërtet këtë shpresë e disa të tjerë e përmendin vetëm si fjalë, pa përmbajtje.

Sidoqoftë, ky synim ka nevojë për një rrugë praktike. Nuk mund të realizohet asnjë synim pa përpjekje dhe mund. Kur mendojmë për rrugët praktike për këtë qëllim, gjejmë se më e mira dhe më e madhja ndër to është personaliteti i lartë në gjithë krijimin, pra, vetë figura e bekuar e Profetit të nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), e cila bashkon ndjenjat dhe bindjet e përgjithshme të myslimanëve”.⁹

9 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 15.08.1995.

Uniteti islam: hapi i parë drejt krenarisë islame

Krenaria islame, në një nga kuptimet e saj, qëndron në mosvarësi dhe pavarësi, në kundërshtim me vartësinë apo nënshtrimin ndaj forcave të huaja. Kjo bëhet më e qartë, kur kuptojmë se rrugët e kolonializmit zakonisht fillojnë me përçarjen dhe shpërndarjen e forcave të ndryshme, me qëllim që të vihen nën kontroll. Prandaj, shfaqja e parullës për unitet midis myslimanëve është një domosdoshmëri e detyruar nga nevoja për ndërtimin e qytetërimit, nëpërmjet forcimit të krenarisë së brendshme përballë atyre që duan ta shfrytëzojnë atë.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Ata që ngrenë flamurin e bashkimit, të unitetit dhe vëllazërisë midis myslimanëve nuk janë armiq të tyre – përkundrazi, janë miqtë e myslimanëve. Ata duan të mirën për ta dhe synojnë krenarinë e të gjithë myslimanëve në botë. Çfarë dobie ka që myslimanët, nga medh’hebe të ndryshme, të qëndrojnë kundër njëri-tjetrit, të sulmojnë njëri-tjetrin dhe më pas të vijë armiku, t’i rrethojë të dyja palët, t’i përplasë kokë më kokë dhe të përfitojë nga përçarja e tyre?! A është kjo gjë e drejtë?...

Uniteti i myslimanëve do t’i japë botës islame krenari. Janë mbi një miliard myslimanë në botë që besojnë në një Zot, në një Profet, në një namaz, në një haxh, kanë një Kible, kanë një Kur’an dhe shumë dispozita të përbashkëta

fetare, ndërkohë që ndryshimet mes tyre janë të pakta. A është e arsyeshme të përqendrohen te këto pak dallime dhe të luftojnë për to, që t'u japin mundësi atyre që kundërshtojnë Zotin, Profetin, fenë dhe gjithçka, të realizojnë projektet e tyre?!¹⁰

Në një tjetër rast, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Umeti islam, sot, ka nevojë për unitet, për jetën e tij, për krenarinë, për shpëtimin dhe për ngritjen e flamurit të Islamit. Uniteti ka përparësi mbi të gjitha çështjet dhe nevojat e tjera; ai është më i rëndësishëm se gjithçka tjetër. Pse nuk e kuptojmë domosdoshmërinë e bashkimit midis myslimanëve?! Kemi një barrë të rëndë mbi supe dhe koha është jashtëzakonisht e ndjeshme. Nëse armiqtë arrijnë ta pushtojnë këtë rajon me forcë, bota islame do të mbetet pas, edhe për njëqind vjet të tjera, ashtu siç ndodhi në epokën e kolonializmit, dhe hendeuku mes saj dhe botës moderne industriale do të thellohet edhe më shumë”.

Ne jemi ata që duhet ta mbajmë këtë përgjegjësi. Sot, ne jemi përgjegjës: qeveritë, elitat, personalitetet kulturore dhe fetare. Të gjithë kemi përgjegjësi ndaj unitetit të botës islame. Uniteti i umetit islam, bashkimi i myslimanëve dhe mosfryrja e preteksteve të vogla kanë qenë gjithmonë ndër çështjet më thelbësore që imami ynë i madh, Imam Khomenini (*Zoti e mëshiroftë!*) i theksonte, që para fitores së

10 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 03.10.1990.

revolucionit dhe deri në fund të jetës së tij. Dhe sot, ne e shohim dhe e kuptojmë se ajo ishte një këshillë tepër e mençur dhe e drejtë”.¹¹

11 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 08.05.2004.

DIJA

Vlera e dijes dhe e mendimit në strukturën e qytetërimit

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Që një popull të jetë i fuqishëm, nuk do të thotë që ai të ketë armë të përparuar. Sigurisht që armët janë të nevojshme, por asnjë popull nuk mund të bëhet i fuqishëm vetëm duke pasur armë. Kur e shikoj këtë çështje, gjej se ka tri elemente thelbësore të forcës dhe fuqisë. Deklarata që shpalla, me rastin e fillimit të vitit, përmban dy nga këto tri elemente. Nëse këto tri elemente bëhen objektiva të një populli, ai do të bëhet i fuqishëm: një - është ekonomia, i dyti - kultura, dhe i treti - dija dhe njohuria.

Elementi i mendimit dhe dijes konsiderohet si një nga shtyllat pa të cilën nuk mund të ndërtohet një qytetërim. Është baza mbi të cilën njerëzit, shteti dhe institucionet ndërtojnë mënyrën e jetesës dhe sjelljen e tyre. Prandaj, ai thotë: “Për të krijuar një qytetërim islam, si çdo qytetërim tjetër, kërkohen dy elemente kryesore: *prodhimi i mendimit* dhe *edukimi i njeriut*. Mendimi islam është si një det i thellë, ose i ngjan oqeanit... të zhyturit në këtë oqean të madh, të arriturit e thellësive të tij dhe eksplorimi, të gjitha këto të

nxjerra nga libri (Kur'ani) dhe Suneti, janë një detyrë për të gjithë dhe një veprim që duhet të bëhet përgjatë kohës. 'Prodhimi i mendimit' në çdo epokë, në përputhje me nevojat e asaj kohe nga ky oqean i madh i njohurive, është diçka e mundur dhe e lehtë".¹²

Për këtë arsye, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) beson se kriteri mbi të cilin mund të matet përparimi ose rënia e çdo qytetërimi është forca ose dobësia e strukturës së tij shkencore dhe mendimore. Nga ky këndvështrim, Ai ka thënë për qytetërimin perëndimor: "Ky qytetërim dhe mbrojtësit e këtij qytetërimi, janë mposhtur edhe në fushën e logjikës së identitetit, sepse themelet shkencore të qytetërimit materialist perëndimor po rrëzohen, njëra pas tjetrës. Kanë dalë shkencëtarë dhe kanë hedhur poshtë idetë e tyre, si në fushën e shkencave humane, ashtu edhe në fusha të tjera. Si rrjedhim, themelet shkencore të këtij qytetërimi po lëkunden sot".¹³

12 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 14.07.1379 hixhri (5 tetor 2000).

13 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 06.03.2014.

Lidhja e dijes me disa vlera

1- Lidhja e vlerës së dijes me lirinë dhe drejtësinë

Marrëdhënia mes vlerave është një marrëdhënie vertikale, ku disa prej tyre gjykojnë mbi të tjerat dhe disa vendosen përpara të tjerave. Në çështjen e dijes, qofshin këto dije akademike apo dije fetare të medresesë, dija nuk është një vlerë absolute, e vendosur mbi të gjitha vlerat e tjera, por është një vlerë e varur nga drejtësia shoqërore si një vlerë tjetër, ashtu siç është e varur, si të gjitha vlerat, nga qëllimi përfundimtar i njerëzimit, që është adhurimi i Allahut të Madhëruar.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Liria e vërtetë e njerëzve dhe e popujve është përdorimi i vullnetit, vendosmërisë, forcës dhe aftësisë së tyre për lumturinë dhe mirëqenien e vet. Duhet që kjo mirëqenie të jetë në rrugën e adhurimit të vërtetë të Allahut të Madhëruar.

Kjo është ajo që ne përpiqemi të realizojmë. Ky është boshllëku që rëndon mbi botën e liberalizmit dhe të demokracisë perëndimore. Ata ndërtuan fabrika, vunë në lëvizje motorët, zgjeruan horizontin e dijes, por dështuan në realizimin e drejtësisë shoqërore. Ata i çuan moralet njerëzore drejt greminës së rënies dhe degradimit”.¹⁴

14 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 02.01.2008.

Prandaj, ajo që duhet pasur parasysh, kur synohet zhvillimi shkencor në çdo organizim apo shoqëri, është që vëmendja të përqendrohet te synimi i vlerës së dijes dhe lidhja e saj, me qëllimin përfundimtar të njeriut, sepse “lumturia e njeriut nuk arrihet me zhvillimin e tij shkencor, mbi bazën se dija është mjet për lumturi, por ajo arrihet me qetësinë e shpirtit, me rehatinë e mendjes, me pastërtinë e zemrës, me një jetë të lirë nga ankthi dhe shqetësimi, me qëndrueshmëri e siguri morale, shpirtërore dhe materiale, si dhe me ndjenjën se drejtësia mbizotëron në shoqëri”.¹⁵

2- Lidhja midis dijes dhe fuqisë

Asnjë qytetërim nuk mund të qëndrojë në sistemin botëror pa fuqi politike dhe ekonomike, përndryshe, ai do të jetë i varur nga të tjerët dhe nuk do të jetë i pavarur. Fuqia ka shumë shkaqe dhe, ndër më të rëndësishmet, është dija.

I nderuari Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Ajo që është më e rëndësishme në krijimin e fuqisë kombëtare, sipas mendimit tim, janë dy gjëra: e para- është dija dhe e dyta- është besimi. Dija është themeli i fuqisë, qoftë sot, qoftë gjatë gjithë historisë apo edhe në të ardhmen. Kjo dije, ndonjëherë, çon në një shpikje ose zbulim, e

15 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 02.01.2008.

ndonjëherë jo. Po ashtu, njohuria është baza e fuqisë; ajo krijon pasuri dhe çon në fuqi ushtarake dhe politike.

Në një hadith thuhet: *“Dija është pushtet; kush e fiton, vepron me të, e kush nuk e fiton, do të veprohet kundër tij”*.¹⁶

Pra, çështja ka dy aspekte: nëse zotëroni dije, mund të keni fjalën dhe dorën e sipërme; nëse nuk e zotëroni, nuk ka gjendje të ndërmjetme. Ai që e zotëron dijen, do të ketë dorën e sipërme mbi ju, do të ndërhyjë në pasuritë tuaja dhe në fatin tuaj. Thesaret e njohurive islame janë të mbushura me fjalë të tilla.

Aspekti tjetër është besimi, i cili ka rëndësi më vete dhe kërkon një diskutim të veçantë. Bazuar në këtë, duhet të mbështetemi te dija”.¹⁷

Ai, gjithashtu, thotë: “Mbështetja jonë te dija nuk kufizohet vetëm në respektin parimor për dijen, gjë që, në vetvete, është shumë e rëndësishme dhe Islami i ka dhënë dijes një vlerë të brendshme, por, përveç kësaj vlere të brendshme, dija është fuqi. Nëse një popull dëshiron të jetojë me rehat, nder dhe dinjitet, ai ka nevojë për fuqi. Faktori themelor që i jep fuqi çdo populli, është dija. Dija

16 *“Shrehu Nahxhul Belaga”* i Ibn Ebil Hadid, Abdul Hamid ibn Hebetullah, vëll. 20, f. 319, përgatitja dhe redaktimi: Muhamed Ebul Fadl Ibrahim, botuar nga Biblioteka e Ajatullah Mera’shi Nexhefi, Iran – Kum, 1404 hixhri, Botimi i parë.

17 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 02.02.2010.

mund të sigurojë fuqi ekonomike, të krijojë fuqi politike dhe, gjithashtu, t'i japë çdo populli reputacion dhe dinjitet kombëtar në sytë e botës".¹⁸

Dija: masa e vetëbesimit

Ashtu siç është dija e domosdoshme për individin, ashtu është edhe për shoqërinë dhe popullin. Siç është thënë në përmbajtjen e disa transmetimeve, dija është pasuri, që pas saj nuk ka varfëri. Një shoqëri e ditur, që përpiqet të zbatojë vlerën e dijes në stilin e jetës dhe në institucionet e saj, shfaq besim shoqëror dhe ky besim bëhet rrugë për vlera të tjera, si refuzimi i padrejtësisë dhe kolonializmit, si dhe liria.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: "Një nga shqetësimet kryesore të kolonializmit, arrogancës botërore, Amerikës dhe sionistëve që krijojnë korrupsion në botën e sotme, është që vendet me sisteme revolucionare të mos i lejojnë të përparojnë nga ana shkencore. Kjo ndjeshmëri është edhe më e madhe për vendin tonë, sepse ndjeshmëria që ata mbajnë ndaj Islamit dhe Revolucionit Islamik, nuk e kanë pasur dhe nuk do ta kenë kurrë ndaj ndonjë revolucionit tjetër. Sot, ata që mund ta zhvillojnë dijen në këtë vend, duhet të ndiejnë përgjegjësinë e tyre më shumë

18 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 06.08.2013.

se kurrë, sepse armiku nuk dëshiron të na lejojë të qëndrojmë mbi këmbët tona. Ky vetëbesim realizohet vetëm kur dija buron nga vetë ne dhe kur duart tona nuk janë të shtrira për të lypur nga armiqtë”.¹⁹

Për këtë arsye, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) e konsideron zhvillimin shkencor të popullit iranien si një tregues të vetëbesimit të tij, ku thotë: “Një nga dëshmitë e këtij vetëbesimi është hyrja e popullit iranien në fushat e zbulimeve shkencore në nivelet më të larta, përfshirë projektin e energjisë bërthamore, i cili është bërë temë kryesore në mesin e popullit tonë. Madje çështja nuk kufizohet vetëm në këtë. Të rinjtë tanë kanë dëshmuar praninë e tyre në shumë fusha të ndjeshme, të sakta dhe shumë moderne, dhe shkencëtarët e ekspertët tanë kanë hyrë në fushë me gjithë forcën, duke realizuar shumë vepra të mëdha, si qelizat burimore dhe zbulimi i ilaçeve për disa sëmundje të pashërueshme”.²⁰

19 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 29.09.1368 sipas kalendarit hixhri (20 dhjetor 1989 në kalendarin gregorian.)

20 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 02.01.2008.

Ndërlidhja e vlerës së dijes me degët e tjera të ndërtimit të shoqërisë

Ndërtimi i shoqërisë përbëhet nga disa elemente, që lidhen fort bashkë, prandaj, nuk duhet që vlera e dijes të përjashtojë çështje të tjera, siç janë letërsia dhe arti. Për këtë arsye, duhet të synohet një integrim mes të gjitha degëve të qytetërimit, që ecin përkrah përparimit shkencor. Imam Khamenei thotë: “Unë nuk jam prej atyre që mohojnë vlerën e poezisë dhe artit, dhe i sakrifikojnë ato në favor të dijes. Edhe pse besoj se dija zë vendin e parë, për nga rëndësia në përparimin e vendit, megjithatë, unë mendoj se dija nuk ndahet nga feja, arti, shija, industria dhe të gjitha llojet e ndërtimit, bujqësisë, shërbimeve publike dhe marrëdhënieve të jashtme, të gjitha këto përbëjnë një tërësi dhe duhet të përparojnë së bashku, secila në mënyrën e vet”.²¹

Gjithashtu, ai thotë: “Përveç kësaj, është e domosdoshme të merren parasysh parimet dhe objektivat, pasi shoqëria njerëzore ka vuajtur në shumë etapa të historisë nga ndarja e parimeve etike dhe morale prej zhvillimit shkencor. Prandaj, ndër bazat mbi të cilat duhet ndërtuar, është bashkimi mes prirjes shkencore dhe asaj parimore. Pritet që universiteti gjithmonë, dhe në çdo vend, të jetë një qendër nga ku burojnë dhe ndriçojnë dy rrjedha

21 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 05.01.2008.

jetësore në vend: e para - është rrjedha e dijes dhe e kërkimit shkencor dhe e dyta - është rrjedha e prirjes parimore, kërkimi i idealeve dhe përcaktimi i objektivave politike e shoqërore”.²²

Hapi i parë për të rrënjosur vlerën e dijes në shoqëri

Dija nuk është një çështje që ka një ekzistencë të ndarë nga bartësi i saj. Shkencëtarët, profesorët dhe mendimtarët janë përfaqësues të kësaj vlere. Prandaj, marginalizimi i dijetarëve dhe mohimi i të drejtave të tyre është një nga gjërat më kundërshtuese për çdo shoqëri apo organizatë që pretendon të mbështesë vlerën e dijes. Në të kundërt, mund të thuhet se hapi i parë për të ngulitur vlerën e dijes në zemrat e njerëzve është nderimi i dijetarëve.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Respekti që mbaj në zemrën time për profesorin dhe dijetarin, dua të reflektohet në nivelin e shoqërisë. Ne kemi nevojë që dijetarët dhe profesorët tanë të ndihen të nderuar dhe të respektuar në shoqëri. Nxitësi më i mirë për përhapjen e dijes është nderimi i bartësit të saj. Profesorët tanë universitarë, figurat e shquara dhe elita në qendrat

22 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 14.12.2008.

kërkimore janë ndër personazhet shkencore dhe elitare të veçanta”.²³

Roli i mësuesit në përhapjen e vlerës së dijes

Ashtu siç duhet të nderohet bartësi i dijes për të përhapur vlerën e saj në shoqëri, po ashtu mësuesi dhe çdo punonjës në fushën e mendimit dhe kulturës ka përgjegjësi të rëndësishme në ndërtimin e mendësisë së nxënësve dhe studentëve, për të respektuar dhe për të përvetësuar vlerën e dijes në nivel individual. Detyra e mësuesit nuk është vetëm të japë mësim. Detyrat më të rëndësishme të tij mund të përmbliidhen në katër pika:

1- Mësimdhënia e informacionit- d.m.th. transmetimi i njohurive të nevojshme për nxënësin, sipas nivelit të tij arsimor.

2- Mësimdhënia e mendimit - d.m.th. mësimi i metodave logjike që e ndihmojnë nxënësin të prodhojë njohuri vetë.

3- Edukim moral - që e mbron personalitetin shkencor nga arroganca dhe devijimi, pasi dija, në vetvete,

23 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 24.09.2008.

mund të çojë në korrupsion, nëse nuk shoqërohet me vlera etike.

4- Krijimi i një mjedisi shkencor, që nxit optimizëm dhe vetëbesim.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Mësuesi duhet të japë dije, por, në të njëjtën kohë, duhet të mësojë edhe metodën e të menduarit dhe procesin e mendimit, si dhe të përfshijë në punën e tij edhe edukimin e sjelljes dhe moralit. Nëse e marrim arsimin në kuptimin e tij të gjerë, ai përfshin këto tri fusha:

1- Mësimdhënien e dijes, domethënë, mësimin e përmbajtjes së librave dhe shkencave, që duhet t’i mësojnë fëmijët tanë, burrat dhe gratë e të ardhmes së vendit tonë. Kjo është një nga detyrat.

2- Detyra e dytë, e cila është më e rëndësishme se e para, është mësimi i mënyrës së të menduarit. Fëmijët tanë duhet të mësojnë se si të mendojnë, mendim të saktë dhe logjik, dhe duhet të udhëhiqen drejt reflektimit të drejtë. Sipërfaqësia në të menduar dhe edukimi sipërfaqësor për çështjet jetësore e paralizon shoqërinë dhe i sjell asaj dështim dhe mjerim në plan afatgjatë...

3- Çështja e tretë është sjellja dhe morali, domethënë mësimi i sjelljes dhe moralit”.²⁴

Ai, gjithashtu, thotë: “Profesori ka një ndikim të madh në mendjen e nxënësve të tij. Kjo është veçoria e ‘profesionalizmit mësimor’, në kuptimin që përparësia juaj shkencore ndaj nxënësit dhe dija që ia ofroni atij, ju jep një pozitë me ndikim në mendjen dhe personalitetin e tij. Shfrytëzoheni këtë pozitë për edukimin dhe mësimin e studentëve. Ne, sot, kemi nevojë që të rinjtë tanë të kenë shpirt optimist, të jenë të guximshëm dhe plot shpresë, me vetëbesim dhe besim, me shpirt largpamës dhe mendim për të ardhmen, si dhe shpirt shërbimi. Kjo është ajo çfarë duhet të bëjë studenti. Epo mirë, ju mund ta siguronit këtë në një mjedis shkencor dhe në klasën mësimore”.²⁵

Dallimi mes përvetësimit të dijes dhe prodhimit të saj

Zhvillimi i çdo grupi shoqëror varet nga niveli i dijes, kulturës dhe mendimit që ai zotëron. Këto elemente i japin identitetin e tij origjinal. Prandaj, ky grup duhet të krijojë mendimin që i përshtatet, përmes krijimtarisë së mendimtarëve të tij dhe atyre që punojnë në fushën e kulturës dhe dijes. Kjo nuk e përjashton mundësinë që

24 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 07.05.2014.

25 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 02.07.2014.

mendimtarët dhe dijetarët të përfitojnë nga të tjerët, ky përfitim quhet “përvetësim i dijes”.

Por ndërtimi i një qytetërimi dhe shoqërie, përveç përvetësimit, kërkon edhe krijimin dhe prodhimin e dijes, në përputhje me nevojat e tokës së shoqërisë. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Nuk duhet të kënaqemi vetëm me përvetësimin e dijes, por qëllimi i kërkimeve dhe arsimit tonë duhet të jetë prodhimi i dijes; pra, të arrijmë në pikën nga ku shpërthen shkëndija e krijimeve shkencore në botën njerëzore sot. Ne, nga pikëpamja e mundësive, nuk kemi ndonjë mungesë, në krahasim me ata që kanë prodhuar dije në botë, e që kanë punuar për zhvillimin dhe përparimin e saj, dhe kanë arritur të krijojnë teknologji të ndërlikuara, duke u mbështetur në dijet e tyre”.²⁶

Ai, gjithashtu, thotë: “Përparimi shkencor arrihet duke përvetësuar dijen nga vendet dhe qendrat shkencore më të përparuara, por përvetësimi i dijes është një gjë, dhe prodhimi i saj është një gjë tjetër. Në çështjen e dijes, nuk duhet ta lidhim karrocën tonë pas lokomotivës së Perëndimit. Natyrisht, nëse ndjekim atë, do të ketë njëfarë përparimi... kjo është e padiskutueshme. Por vartësia, mungesa e krijimtarisë dhe nënshtrimi shpirtëror janë pasoja të pashmangshme të një situate të tillë, dhe kjo është

26 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 08.08.1382 sipas kalendarit persian.

e papranueshme. Prandaj, ne duhet ta prodhojmë dijen vetë, ta shpërthejmë nga thellësitë tona. Çdo shkallë që ngjitet njeriu në shkallët e dijes, e përgatit për hapin pasardhës dhe për t'u ngritur në një nivel më të lartë. Duhet të vazhdojmë këtë lëvizje nga vetja jonë, nga brendësia jonë, duke përdorur burimet tona mendore dhe thesaret e trashëgimisë sonë kulturore”.²⁷

Përkushtimi ndaj dijes përbën në vetvete një xhihad

Kuptimi i xhihadit në Islam i referohet një lëvizjeje aktive dhe të orientuar drejt realizimit të objektivave hyjnore, që Allahu i Lartësuar dëshiron nga shoqëria islame. Ai përfshin aspekte të ndryshme dhe nuk është i kufizuar vetëm në aspektin ushtarak. Meqë dija është një prej vlerave thelbësore, pa të cilën asnjë shoqëri nuk mund të qëndrojë, atëherë arritja dhe prodhimi i dijes është një nga format e xhihadit.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Në këtë lëvizje nuk lejohet të jemi përtacë, dembelë apo të varemi nga të tjerët. Duhet të punohet sikur je në luftë. Xhihadi nuk kufizohet vetëm në fushat e luftës, por duhet të ketë xhihad edhe në fushën e dijes, ashtu si në të gjitha fushat e tjera të jetës. Xhihad - do të thotë punë pa ndalim, pranim i

27 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 24.09.2008.

rreziqeve (brenda kufijve të arsyeshëm, natyrisht), përparim dhe shpresë në të ardhmen”.²⁸

Respektimi i përparësive shkencore

Shoqëria nuk duhet të merret me çështje shkencore që nuk sjellin fryte civilizuese. Përkundrazi, përpjekjet në fushën e prodhimit të dijes duhet të përqendrohen në përparësitë që ka nevojë shoqëria. Nëse duam të zhvillojmë shoqërinë tonë, duhet, siç thekson Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) , “të përcaktojmë nevojat dhe përparësitë shkencore dhe t’i marrim parasysh ato në programimin arsimor. Lidhur me shkencat humane, shkencat bazë dhe disa shkenca eksperimentale, ose në nivele të ndryshme të kërkimit shkencor, mund të dalin përparësi të caktuara pas një studimi dhe shqyrtimi të saktë. Duhet t’i kushtojmë vëmendje këtyre përparësive dhe t’i marrim parasysh në procesin e planifikimit. Meqë kemi mundësi të kufizuara dhe shumë nevoja, nuk duhet të lejojmë që të investojmë mendërisht, financiarisht, njerëzisht dhe në kohë, në një projekt që nuk gëzon përparësi”.²⁹

28 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 24.09.2008.

29 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 24,09,2008.

Detyra e universitetit ndaj studentëve

Një aspekt tjetër i mënyrës së ruajtjes së shoqërisë dhe rinisë sonë, në të gjitha nivelet, është në duart e universitarëve dhe universiteteve. Këtë e ka sqaruar udhëheqësi, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*), në shumë prej fjalimeve të tij, të cilat do t'i përmendim njëra pas tjetrës nën titujt e mëposhtëm:

1. Kujdesi për edukimin e studentëve

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Universiteti duhet të kujdeset për edukimin e studentëve, nga aspekti kulturor, moral dhe i formimit të identitetit; d.m.th. çështja e edukimit është më e rëndësishme se çështja e mësimdhënies. Natyrisht, edukim me drejtim etik dhe shpirtëror, zbutje shpirtërore dhe përhapje e ndjenjës së identitetit të radhët e studentëve”.³⁰

2. Edukimi i studentëve për t'i përgatitur ata për udhëheqjen e shoqërisë (në moral, kulturë dhe identitet)

Universitetet duhet të përpiqen të edukojnë studentë të aftë, për të udhëhequr shoqërinë islame. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Për sa i përket edukimit të studentëve, në aspektin e moralit, kulturës dhe identitetit, çështja parësore është përgatitja e forcës së arsyes. Po çfarë

30 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 10.06.2018.

është forca e arsyes? Çfarë është arsyeja? Arsyeja në letrat islame nuk është thjesht ajo pajisje që na ndihmon të kryejmë llogaritje materiale, jo. ‘Arsye është ajo me të cilën adhurohet Mëshiruesi dhe fitohet Xheneti’.³¹ Kjo është arsyeja. ‘Arsyeja udhëzon dhe shpëton’.³² Kjo është arsyeja. Arsyeja duhet ta ngrejë njeriun në nivele më të larta. Arsyeja, në një nga nivelet e saj, është ajo forcë që e çon njeriun në pozitën e afërsisë [me Zotin] dhe në pozitën e teuhidit (njësimi të Zotit).

Në një nivel më të ulët, arsyeja është ajo që e udhëzon njeriun drejt një mënyre jetese islame. Në një nivel tjetër, arsyeja është ajo që rregullon marrëdhëniet materiale të jetës në këtë botë. Të gjitha këto janë funksione të arsyes. Forca e arsyes është ajo forcë që mund t’i përfshijë të gjitha këto aspekte. Prandaj, ajo ka nevojë për edukim shpirtëror.

“Edukojini studentët me një edukim shpirtëror. Këta janë të rinj dhe i riu është natyrshëm i butë, relativisht i pastër dhe ka aftësi për të ecur në drejtimin shpirtëror. Kjo

31 El Kulaini, Shejkh Muhamed ibn Jakub, “*El-Kafi*”, vëll. 1, f. 11, përgatitur dhe korrigjuar nga Ali Ekber El Ghafari, Darul Kutubil Islamiye, Iran – Teheran, 1407 hixhri, Botimi i katërt.

32 Et Temimi El Amidi, Abdul Uahid ibn Muhamed, “*Gurerul Hikem ue Durer El Kelim*”, f. 124, përgatitur dhe korrigjuar nga Sejid Mehdi Rezaei, botuar nga Darul Kitabil Islami, Iran - Kum, 1410 hixhri, Botimi i dytë.

është ajo që duhet të sigurohet në universitet. Nuk mund të përballohet koha (jeta) veçse me arsyen”.³³

Jeta nuk është e mundur pa arsye. Prandaj, duhet që aspekti edukues i kësaj force të arsyës, të jetë i fortë. Universiteti duhet të edukojë të rinj me besim, nder, iniciativë, që nuk janë dembelë, që janë të zellshëm, të përpiktë dhe me vetëbesim, si dhe nga ata që pranojnë të vërtetën dhe e kërkojnë atë.

Këto janë cilësitë e njeriut të lartë. Ky është njeriu që e do Islami dhe ky është njeriu që, nëse merr drejtimin e shoqërisë, do të mund ta drejtojë atë drejt përmirësimit dhe shpëtimit.

Përndryshe, le të marrim për shembull atë që është bërë e zakonshme sot në hapësirën virtuale: njerëzit shajnë njëri-tjetrin, akuzojnë njëri-tjetrin, njëri e sulmon tjetrin për ndonjë dobësi të vogël, ia nëpërkëmbin dinjitetin një njeriu besimtar, e askush nuk e di kush është ai.

Sigurisht, kjo është një gjë shumë e keqe. Ka gjëra të tilla mes të rinjve tanë dhe duhet të parandalohet kjo. Kjo gjë është e mundur përmes edukimit shpirtëror”.³⁴

33 “*Biharul Enuar*”, i autorit El Al'lame Muhamed Bakir ibn Muhamed Teki El Mexhlisij, vëll. 75, f. 7, Botimet El Uefa, Liban – Bejrut, viti 1403 hixhri/1983, Botimi i dytë.

34 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 28.05.2018.

Më pas, Imam Khamenei (Allahu e ruajtë!) paraqet disa shembuj që duhet të vihen në qendër të vëmendjes në procesin edukativ në universitet. Disa prej tyre po i përmendim më poshtë:

a- Edukimi i studentëve mbi moralin e jetës islame

Imam Khamenei (Allahu e ruajtë!) thotë: “Në një mbledhje të Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), një person ofendoi nderin e një besimtari dhe e turpëroi atë (pa u sqaruar në hadith në ç’mënyrë ndodhi kjo). Një person tjetër mbrojt besimtarin që u ofendua. Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha: “Ajo që ti bëre, duke mbrojtur nderin e një besimtari, është një pengesë përpara zjarrit të Xhehenemit”.

Kjo është një pengesë para zjarrit të Xhehenemit! Kjo është mënyra islame e jetesës. Do të thotë: “Mëshiro, që të mëshirohesh”.³⁵ Mëshiro, që Allahu të të mëshirojë ty. Kjo është ajo që duhet të mësohet dhe duhet të përhapet te të rinjtë tanë. Të rinjtë tanë duhet të jenë: **“Të ashpër ndaj jobesimtarëve, të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit”**.³⁶

35 Es Saduk, Shejkh Muhamed ibn Ali, “El Emali”, faqja 209, redaktuar nga: Seksioni i Studimeve Islame - fondacioni “El Ba’thetu”, Qendra e Shtypshkronjës dhe Botimit, pranë fondacionit “El Ba’thetu”, Kum - Iran, viti 1417 hixhri, Botimi i parë.

36 Sure “El Fet’h”, ajeti 29.

Të rinjtë duhet të edukohen në këtë mënyrë: të ngrihen kundër padrejtësisë, të ngrihen kundër agresorit, por të jenë të butë dhe të mëshirshëm me vëllain e tyre besimtar. Duhet t'i mësojmë të rinjtë tanë faljen dhe mirëkuptimin. Nëse ky i ri nuk edukohet sot dhe nesër bëhet përgjegjës i një sektori, do ta kryejë detyrën në mënyrë të dobët, të pasigurt ose të gabuar. Ai që sot është i gatshëm ta fyejë dikë për shaka, nga mërzia apo për të kënaqur një ndjesi të brendshme, kur të hyjë nesër në një garë zgjedhore për shembull, do të jetë i gatshëm ta shkelë plotësisht një njeri besimtar – vetëm për të fituar! Kështu do të jetë ai nesër. Dhe kjo do të ketë pasoja edhe atje”.³⁷

b- Edukimi mbi moralin e marrëdhënieve shoqërore

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Marrëdhëniet e njerëzve dhe bashkëjetesa e tyre të jenë të ndërtuara mbi moralin. Kjo përfshin mëshirën, altruizmin, bashkëpunimin, ndihmën dhe të ngjashmet me to. Zhvillimi dhe rritja e këtyre virtyteve morale lidhet ngushtë me mënyrën se si njerëzit bashkëjetojnë në shoqëri”.³⁸

37 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 28.05.2018.

38 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 28.05.2018.

c- Krijimi i kushteve për zhvillim dhe ngritje shpirtërore

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Përgatitja e kushteve për zhvillimin shpirtëror dhe çlirimin nga robëria e epsheve dhe zemërimit për individët e denjë, kjo është ndër dëshirat më të larta dhe shpresat më të mëdha që shpesh harrohet. Duhet të krijohen kushte të tilla që njerëzit e përgatitur e të denjë, të mund të ecin në këto rrugë, dhe të rriten figura të ngjashme me Haxhi Mirza Ali Kadij dhe Al’lameh Tabatabai, dhe personalitete të tjera të mëdha si ata. Këta janë njerëz të lartë dhe të përkryer, që arriten të çlirohen nga ky mjedis material dhe të ngrihen lart e të fluturojnë drejt të lartës. Duhet të përgatiten kushtet për këtë zhvillim dhe ngritje shpirtërore. Sigurisht, jo të gjithë kemi atë përgatitje, por mes nesh ka individë që kanë aftësinë për këtë lëvizje, veçanërisht në periudhën e rinisë.

Ai i tha: “Ti je skllavi i skllëvërve të mi, si të ngrihem për ty?!”

Në ngjarjen e njohur, Diogjeni³⁹ i urtë, iu drejtua Aleksandrit dhe i tha: “Ti je skllav i skllëvërve të mi!” Aleksandri po ecte në rrugë dhe i urti ishte ulur. Nuk iu

39 Diogjeni i Sinopës (Diojanis El Kelbij) ishte një filozof grek (421–323 para erës sonë).

drejtua, nuk u ngrit për ta nderuar. Aleksandri u mërzit dhe u tha rojeve të tij:

- Shikoni, kush është ky? Silleni!

Kur e çuan te ai, e pyeti:

- Pse nuk u ngrite për të më respektuar?

- S'kam asnjë arsye të ngrihem për ty... ti je skllav i skllavëve të mi!

- Ç'do të thotë kjo? Unë, Aleksandri, një skllav?!

- Po, epshi dhe zemërimi janë skllavërit e mi... unë i kam nën kontroll. Ti je skllav i epshit dhe zemërimit, pra je skllav i një skllavi!

Njeriu i dëshiruar është ai që arrin të shpëtojë nga robëria e epshit dhe e zemërimit. Këto janë ideale të mëdha dhe qëllime të larta".⁴⁰

40 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 28.05.2018.

DREJTËSIA SHOQËRORE

Rëndësia e studimit të vlerave

Çdo qytetërim në botë dhe në histori jeton mbi tri shtylla kryesore, të cilat formojnë piramidën e strukturës së tij kulturore:

E para: Baza e përfaqësuar nga botëkuptimi dhe filozofia, që shpjegon ekzistencën.

E dyta: Maja e piramidës, që është sistemi praktik dhe sjellja, si në nivel individual, ashtu edhe shoqëror, që është në përputhje me botëkuptimin për ekzistencën.

E treta: Ndërmjet bazës dhe majës ekziston një shtresë shumë e rëndësishme: shtresa e vlerave.

Me vlera nënkuptojmë ato çështje dhe ide që rregullojnë sjelljen, gjëra që janë të mira ose të këqija.

Për shembull: Nga botëkuptimet kozmike është besimi në ekzistencën e një Krijuesi të kësaj jete dhe të jetës pas vdekjes (Ringjallja).

Nga shembujt e sjelljes është, për shembull, ndalimi i konsumimit të alkoolit.

Nga shembujt për vlerat është, për shembull, mirësia e drejtësisë dhe shëmtia e padrejtësisë.

Studimi i vlerave ka qenë një nga temat që ka zënë mendjet e mendimtarëve të botës ndër shekuj. Në krye të këtyre vlerave që kanë tërhequr vëmendjen e mendimtarëve, qëndron vlera e drejtësisë. “Drejtësia ka qenë shqetësimi i njeriut gjatë gjithë historisë, në çdo kohë. Në përputhje me ndjenjën e nevojës për drejtësi, e cila ka përfshirë gjithë njerëzit përgjatë historisë dhe vazhdon edhe sot, mendimtarët, filozofët dhe dijetarët janë futur në këtë temë dhe ajo është bërë qendër e vëmendjes së tyre. Prandaj, janë zhvilluar kërkime dhe janë paraqitur teori jo vetëm mbi drejtësinë si koncept i përgjigthsëm, por edhe për drejtësinë shoqërore, që nga kohët e lashta deri në ditët tona, në këtë kuptim të gjerë”.⁴¹

Për sa u përket feve, çështja e drejtësisë ka qenë gjithmonë një shtyllë thelbësore në shpalljen e urdhrat të Allahut të Lartësuar. Profetët, ashtu siç i përshkruan

41 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

Kur'ani i shenjtë, kanë qenë thirrës të drejtësisë dhe luftues të padrejtësisë së tiranëve të kohës së tyre.

Prandaj, në historinë teorike dhe praktike të drejtësisë, shohim qartë se “roli i feve ka qenë i veçantë; domethënë, ajo që kanë thënë fetë nëpër kohë, lidhur me drejtësinë, ajo që kanë synuar dhe i kanë kushtuar rëndësi, ka qenë e pazakontë dhe e jashtëzakonshme. Një kujdes i tillë që fetë i kanë dhënë drejtësisë, nuk e gjejmë në mendimet e filozofëve apo të dijetarëve”.⁴²

Llojet e drejtësisë në Islam

Në Islam, drejtësia nuk kufizohet në një kuptim të vetëm, por ajo shtrihet në fusha të ndryshme. Në përgjithësi, ekzistojnë tri lloje drejtësie:

1- Drejtësia që trajtohet në shkencën e etikës (akhlakut): Kjo ka të bëjë me ekuilibrimin e forcave të brendshme të njeriut dhe cilësive shpirtërore të tij. Është quajtur “koka e moralit”, sepse çdo cilësi morale ka dy skaje të rrezikshme: ekzagjerim dhe neglizhencë, ndërsa drejtësia është gjendja e ekuilibrit të dëshiruar. Por ky kuptim i

42 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

drejtësisë nuk është objekt i diskutimit tonë, sepse këtu po flasim për vlerën e drejtësisë shoqërore.

2- Drejtësia që trajtohet në jurisprudencë (fik'h): Kjo është një cilësi e qëndrueshme në shpirtin e besimtarit, që e shtyn atë drejt devotshmërisë (tekua), duke u përmbajtur nga ndalesat dhe duke kryer detyrimet. Edhe ky lloj drejtësie nuk është objekti i diskutimit këtu.

3- Drejtësia shoqërore (tema jonë kryesore): Kjo ka të bëjë me ndërtimin e themeleve të barazisë dhe drejtësisë brenda shtresave të ndryshme të shoqërisë islame. Ky është objekti i kërkimit tonë në kontekstin e vlerave.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) shpjegon dallimin mes këtyre kuptimeve të drejtësisë dhe thotë: “Drejtësia midis njeriut dhe vetes së tij është një temë më vete, që nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me drejtësinë shoqërore. Në Ku’ran, në shumë ajete, shfaqet shpesh “padrejtësia ndaj vetvetes”.

Në lutjen (duanë) e Kumejlit, lexojmë: “*I kam bërë padrejtësi vetes sime*”.⁴³ Në përgjërimet e muajit Shaban,

43 Al Kaf'ami, “*El Beladul Emin ue Ed Dira'ul Hasijn*”, f. 188, botuar nga “Mu’asseset El A’lamij”, Liban – Bejrut, viti 1418 hixhri, Botimi i parë.

thuhet: *“Kam qenë i padrejtë ndaj vetes sime, në mënyrën si e kam parë atë, ajo është në mjerim, nëse nuk e fal atë”*.⁴⁴

Mëkatet, gabimet, ndjekja e epsheve, ndjekja e dëshirave të kota, largimi nga përmendja e Zotit dhe mungesa e përvetësimit ndaj Tij, të gjitha këto janë padrejtësi ndaj vetes. Kjo fushë është shumë e rëndësishme. Kur flasim për drejtësinë në marrëdhëniet shoqërore dhe ndërtimin e një sistemi shoqëror, nuk mund të neglizhojmë drejtësinë me vetveten. Nuk duhet të sillemi padrejtësisht me veten, por ta trajtojmë atë me drejtësi.

E kundërta e shprehjes *“Kam qenë i padrejtë me veten time”*, është pikërisht kjo drejtësi, të mos i bëjmë padrejtësi vetes, por të sillemi me drejtësi ndaj saj. Nëse Allahu i Lartësuar na ndihmon të largohemi nga kjo padrejtësi, atëherë ne jemi robërit e Tij të sinqertë dhe kemi shpresë të madhe që, inshallah, të na japë sukses në vendosjen e drejtësisë në shoqëri”.⁴⁵

44 Ibn Tâuûs, *“El Ikbal bil A'malil Husna”*, vëll. 3, f. 296, botuar nga “Mektebetul I'lam El Islami”, Iran – Kumm, 1418 hixhri, Botimi i parë.

45 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

Domosdoshmëria e origjinalitetit në kërkimin teorik mbi drejtësinë shoqërore

Nëse duam të nxjerrim qëndrimin e Islamit mbi ndonjë vlerë, përfshirë këtu drejtësinë shoqërore, atëherë është e domosdoshme t'u referohemi teksteve dhe burimeve autentike, si: Kur'an, hadithet dhe jeta e të pagabueshmëve (ma'suminëve). Prandaj, hapi i parë dhe thelbësor në studimin e drejtësisë duhet të jetë: Origjinaliteti i kërkimit nga këndvështrimi islam.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) , për këtë, thotë: “Në fazën teorike dhe të konceptualizimit, duhet t'u drejtohem burimeve islame, për të arritur një teori autentike në çështjen e drejtësisë. Qëndrimi im në këtë pikë është që nuk duhet të përpiqemi të nxjerrim një teori përmes mbledhjes dhe përzierjes së ideve nga mendimtarë e filozofë të ndryshëm që kanë folur mbi këtë temë.

Duhet të jemi shumë të kujdesshëm, që të mos bëjmë ‘përzierje të copëzuar’ të ideve të huaja. Në Kur'an, hadith, “Nehxhul Belaga”, si dhe në tekstet juridike (fik'h), teologjike (kelam) dhe filozofike (hikmet), ekzistojnë shumë studime që mund të shërbejnë si burime të vlefshme për zbulimin e teorisë islame autentike. Megjithatë, njësoj si në shumë fusha të tjera, edhe njohja e mendimeve të të tjerëve mund të na ndihmojë për të kuptuar më mirë burimet tona islame. Kjo është e pranueshme edhe në fushat juridike dhe

të drejtës. Nëse njihemi me ndonjë ide të huaj dhe mendja jonë zgjerohet në mënyrë të drejtë, do të jemi në gjendje të përfitojmë më mirë dhe më thellë nga burimet tona islame. Kjo është e dobishme. Por gjithmonë, qëllimi ynë duhet të jetë të arrijmë te teoria autentike islame, duke u ruajtur nga përzierjet sipërfaqësore të ideve të ndryshme.

Dhe, sigurisht, është e vetëkuptueshme se arsyeja pse themi se teoria islame duhet të jetë e pastër dhe origjinale, është fakti që çështja e drejtësisë është e ndërtuar mbi bazat dhe themelet e njohjes së ekzistencës, shkencës së njohjes dhe shtyllave themelore. Nëse duam të mbështetemi te teoritë perëndimore, të cilat ato i marrin për bazë, atëherë, në të vërtetë, do të kemi mbështetur themelet filozofike që ne nuk i pranojmë dhe nuk mund t'i pranojmë. Këto janë pikëpamjet që lidhen me njohjen e ekzistencës”.⁴⁶

Adhurimi: qëllimi përfundimtar i drejtësisë në fe

Kur’ani i shenjtë na tregon se thirrja e profetëve nuk ka qenë aspak e ndarë nga drejtësia shoqërore. Përkundrazi, Kur’ani e përmend drejtësinë si një nga qëllimet kryesore të dërgimit të profetëve, siç thuhet në ajetin:

46 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

﴿لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ﴾

“Ne i dërguam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat dhe peshoren që njerëzit të veprojnë drejt”.⁴⁷

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) e shpjegon këtë ajet duke thënë: “Pa dyshim, ky ajet tregon se qëllimi i dërgimit të profetëve, zbritjes së librave hyjnorë dhe sjelljes së argumenteve të pakundërshtueshme, që janë provat e qarta dhe të qëndrueshme të sjella nga profetët, është që njerëzit të vendosin drejtësinë (*el kistu*).

“*Libri*” i referohet shtjellimit të mësimeve fetare në lidhje me njohjen, rregullat dhe moralin; “*peshoja (el mizan)*” nënkupton vendosjen e standardeve dhe kritereve të drejta”.

Ajo që duhet vënë re në komentimin e thirrjes së profetëve në drejtësi, është se ata nuk ishin thirrës vetëm në një standard e qëllim të vetëm, por thirrja e tyre për drejtësi buronte nga thellësia e fesë dhe përfshinte këtë jetë dhe Jetën Tjetër. Pra, drejtësia ishte rrugë drejt qëllimit përfundimtar të krijimit, që është: adhurimi i Allahut.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “S’ka dyshim se vendosja e drejtësisë (*el kist*) dhe gjithçka që ka të

47 Sure “El Hadid”, ajeti 25.

bëjë me jetën shoqërore dhe individuale të njerëzve, është një hyrje dhe përgatitje për qëllimin madhor të krijimit, që është:

﴿وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ﴾

“Unë nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit veçse që të më adhurojnë”.⁴⁸ Pra, adhurimi është, në vetvete, qëllimi i krijimit; të bëhesh rob i singertë i Allahut është forma më e lartë e përsosjes njerëzore”.⁴⁹

Jeta dhe qëndrimi i profetëve ndaj të shtypurve

Profetët nuk janë mjaftuar vetëm me shpjegimin teorik të drejtësisë hyjnore, ashtu siç kanë bërë disa mendimtarë. Ata kanë luftuar konkretisht për vendosjen e drejtësisë dhe për këtë arsye, kanë qenë kundërshtarë aktivë të tiranëve të kohës së tyre.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Gjatë gjithë historisë, profetët kanë qenë gjithmonë në krah të të shtypurve dhe kanë luftuar praktikisht për drejtësinë. Kini parasysh se Kur’ani ka deklaruar qartë se profetët

48 Sure “Edh Dharijat”, ajeti 56.

Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

përballeshin me tiranët, të pasurit e shfrenuar dhe elitat, të cilët përfaqësonin klasat shtypëse dhe padrejta.

Për shembull, të pasurit e shfrenuar (mütrifun), qëndronin përballë profetëve, siç thotë ajeti:

﴿وَمَا أَرْسَلْنَا فِي قَرْيَةٍ مِّن نَّذِيرٍ إِلَّا قَالَ مُتْرَفُوهَا إِنَّا بِمَا أُرْسِلْتُمْ بِهِ كَافِرُونَ﴾

“Ne nuk kemi dërguar asnjë paralajmërues në ndonjë vendbanim, pa thënë të pasurit e tij: ‘Ne mohojmë atë me të cilën jeni dërguar’”.⁵⁰

Nuk gjejmë asnjë profet pa një grup të pasurish të fuqishëm përballë tij dhe profeti luftonte kundër tyre. Kështu ishte edhe rasti me elitat sunduese, që përfaqësonin pushtetin dhe autoritetin. Fjala “tagut” përfshin të gjithë këta. Prandaj, profetët gjithmonë qëndronin në krah të të shtypurve në përballjen midis padrejtësisë dhe drejtësisë. Ata zbrisnin në fushën e betejës, për drejtësi dhe luftonin realisht, dhe kjo është e pashembullt.

Filozofët kanë folur për drejtësinë, por në shumicën e rasteve, ashtu si shumë mendimtarë, janë mjaftuar me fjalë, pa zbritur në veprim dhe rrezik real.

⁵⁰ Sure “Sebe’”, ajeti 34.

Profetët nuk ishin të tillë. Ata vepronin vetë, madje duke e vënë veten në rrezik.

Kur profetët kritikoheshin për qëndrimin me të varfrit dhe, kur të pasurit u thoshin profetëve: “Pse qëndroni në anën e klasave të shtypura?” ...dhe u kërkonin që të largoheshin prej tyre, profetët nuk pranonin. Shembull është përgjigja e Profetit Nuh (*Paqja qoftë mbi të!*) ndaj kundërshtarëve të tij:

﴿وَلَا أَقُولُ لِلَّذِينَ تَزْدِرِي أَعْيُنُكُمْ لَنْ يُؤْتِيَهُمُ اللَّهُ خَيْرًا اللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا فِي أَنْفُسِهِمْ إِنِّي إِذَا لَمِنَ الظَّالِمِينَ﴾

“Unë nuk ju them se kam thesarin e Allahut apo që e di të padukshmen. As nuk them se unë jam engjëll e as do t’u them atyre, të cilët sytë tuaj i nënçmojnë, se Allahu nuk do t’u japë kurrfarë të mire. Allahu e di më mirë se ç’ka në shpirtrat e tyre. Atëherë, sigurisht që do të isha prej të padrejtëve”.⁵¹ Prandaj, ata që ishin të privuar nga drejtësia, zakonisht ishin të parët që besonin në profetët dhe i mbështesnin”.⁵²

51 Sure “Hud”, ajeti 31.

52 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

Drejtësia dhe fundi i botës

Shumë mendimtarë dhe filozofë të historisë janë përpjekur të hulumtojnë rreth pamjes përfundimtare të botës. Disa prej tyre kanë pasur një qasje pesimiste, duke synuar të teorizojnë një fund tragjik të botës. Ndërkohë, shpresa për realizimin e drejtësisë në botë është ajo që përshkruhet nga Kur'ani dhe të gjitha fetë.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Të gjitha fetë janë të një mendimi që përfundimi i këtij lëvizjeje të madhe historike është një përfundim plot shpresë dhe drejtësi; që do të thotë, ato thonë me siguri të plotë: do të vijë një epokë që do të jetë epoka e drejtësisë, epoka e vendosjes së plotë të fesë. Në lutjen që lexohet pas vizitës së ‘Alë Jasin thuhet: *“Allahu do ta mbushë tokën me drejtësi dhe barazi”*⁵³, ose *“me barazi dhe drejtësi”*,⁵⁴ ku ka variante të ndryshme në vende të ndryshme, *“ashtu siç ishte mbushur me padrejtësi dhe shtypje...”*⁵⁵

Të gjithë profetët, të gjitha fetë dhe të gjitha shpalljet profetike e kanë treguar këtë përfundim, e kanë theksuar dhe e kanë nënvizuar, dhe kanë thënë se bota është në

53 Hilali, Sulejm ibn Kajs, “Libri i Sulejm ibn Kajs Hilalit”, vëll. 2, f. 567, rishikuar nga Ensarî Zenxhanî Khûeynî, botuar nga El Hadi, Iran - Kum, 1405 hixhri, Botimi i parë.

54 Sulejm ibn Kajs, “Libri i Sulejm ibn Kajs”, vëll. 2, f. 775.

55 I njëjti burim, f. 567.

lëvizje drejt tij. Prandaj, që në fillim, gjatë rrugës dhe në përfundim, mbështetja e shpalljeve profetike ka qenë drejtësia. Kjo nuk ka të ngjashme”.⁵⁶

Shkalla e vlerave dhe drejtësia

Në kërkimin rreth vlerave, duhet pasur parasysh se këto vlera nuk janë të gjitha në të njëjtin nivel. Ka vlera që janë të varura nga të tjera dhe vlera që mbizotërojnë mbi të tjerat. Prandaj, kur dy vlera përplasen në një situatë të caktuar, është e domosdoshme të përdorim arsyen, për të përcaktuar se cilës vlerë duhet t’i japim përparësi; për shembull, paqja është një vlerë, sepse lufta është një largim nga natyra dhe nuk është e dëshirueshme, në vetvete. Por, nëse paqja përplasët me drejtësinë, cilën duhet ta zgjedhim?

Nëse vendosemi përballë dy zgjedhjeve, padrejtësi apo luftë, cilën duhet të zgjedhim? A duhet të themi: paqja është një vlerë që duhet t’i japim përparësi ndaj drejtësisë dhe për këtë arsye të pranojmë padrejtësinë për hir të paqes?

Sigurisht që Islami e konsideron drejtësinë si një vlerë që nuk kushtëzohet nga asgjë tjetër dhe nuk është e

56 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

varur nga ndonjë vlerë tjetër, përkundrazi, ajo është ajo që i kushtëzon dhe sundon vlerat e tjera.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Paqja nuk është një vlerë absolute, ajo është një vlerë relative. Në disa raste, paqja është e mirë, në raste të tjera paqja është e keqe dhe lufta është e mirë. Por drejtësia nuk është kështu, drejtësia është një vlerë absolute; pra, nuk ka asnjë rast ku drejtësia të jetë e keqe”.⁵⁷

Burimi i vlerës së drejtësisë në Islam

Ekziston një pyetje qendrore ndër dijetarët e epistemologjisë: Cili është burimi i vlerave? Nga vjen vlera e drejtësisë?

Islami, në përputhje me botëkuptimin e tij teologjik, i ndërtuar mbi teuhidin (besimin në Një Zot), e sheh Zotin e Lartësuar, që është qendra e ekzistencës, si themelin e sistemit të vlerave. Me fjalë të tjera, vlerat duhet të bazohen mbi të vërtetën dhe hyjnore. Allahu i Lartësuar e ka krijuar botën mbi bazën e të vërtetës dhe të urtësisë, prandaj edhe sistemi ligjor dhe ai etik duhet të jetë në përputhje me rendin

57 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

krijues, pra, duhet të burojë edhe ai nga e vërteta. Kjo është për sa i përket origjinës.

Për sa i përket zbatimit, vlera e drejtësisë nuk është nga ato që mund të neglizhohen apo të lihen pas dore. Islami nuk e pranon që njeriu të thotë: “Unë heq dorë nga e drejta ime për drejtësi, nuk kam problem ta pranoj padrejtësinë”. Jo, kjo çështje në sistemin juridik dhe ligjor islam rregullohet në bazë të parimit “të detyrimit” (vaxhib).

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Në Islam, drejtësia buron nga e vërteta... dhe përveç kësaj, në drejtësi ekziston edhe elementi i detyrimit; pra, orientimi drejt drejtësisë në Islam është një detyrë hyjnore. Ndërsa në teoritë perëndimore nuk është kështu. Në këto shkolla të mendimit, qofshin socialiste apo liberale, drejtësia paraqitet në forma të ndryshme. Me gjithë zhvillimet dhe variantet e këtyre ideologjive, në të gjitha këto mendësi, drejtësia nuk është trajtuar si një çështje themelore dhe strukturore, e ndërtuar mbi vlera thelbësore, ashtu siç ndodh në fenë islame”.⁵⁸

58 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

Lidhja e vlerës së drejtësisë me botëkuptimin (rendin kozmik)

Vlerat, çdo qytetërim, ndërtohet mbi botëkuptimin e tij për ekzistencën. Prandaj, një nga gjërat që siguron koherencën e teorisë islame për drejtësinë dhe mbron studiuesit nga rënia në mendësi të huazuara dhe të përziera, është kujdesi për ta lidhur drejtësinë me burimet e saj doktrimore teologjike.

Në këtë drejtim, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Besimi në krijimin (fillimin) dhe në jetën pas vdekjes (ringjalljen) ka një rol themelor në çështjen e drejtësisë, të cilin nuk duhet ta neglizhojmë. Nuk duhet të presim që drejtësia të vendoset realisht në shoqëri, nëse nuk ekziston besimi në krijim dhe në rikthim. Kudo që mungon ky besim, drejtësia kthehet vetëm në një koncept të imponuar dhe të detyruar, asgjë më shumë. Kjo është arsyeja pse disa nga teoritë e bukura perëndimore për drejtësinë nuk janë realizuar kurrë në praktikë: sepse atyre u mungonin shtyllat e besimit. Fjalët janë të bukura, të paktën në pamje, edhe nëse jo shumë të bazuara, por në jetën reale të shoqërive perëndimore, nuk ka asnjë shenjë të vërtetë të drejtësisë. Përkundrazi, ajo që shihet aty, është padrejtësi e plotë. Arsyeja është mungesa e besimit në krijim dhe rikthim.

Besimi në jetën pas vdekjes, në mishërimin e veprave, në shndërrimin e cilësive shpirtërore në Botën Tjetër, të

gjitha këto kanë ndikim të madh. Të jesh i drejtë, të kërkosësh drejtësinë, ta lavdërosh atë dhe të përpiqesh për të, e gjithë kjo do të mishërohet në Ditën e Kiametit. Kjo është pika qendrore që e dallon Islamin nga Perëndimi. Ky besim i jep njeriut energji dhe gjallëri. Njeriu e kupton qartë çfarë katastrofe i ka sjellë vetes me sjelljet e tij të padrejta, madje edhe me mendimet e tij të padrejta, në përputhje me mishërimin e veprave në Botën Tjetër. Një gjë e tillë e afron njeriun patjetër drejt drejtësisë”.⁵⁹

Dy propozime për forcimin teorik të studimit mbi drejtësinë

Së pari, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) e konsideron shkollën fetare (huzen) dhe universitetin si bazën e mendimit që ushqen shoqërinë. Prandaj, kur synohet të bëhet një ndryshim strukturor në shoqëri, pikënisja duhet të jetë nga shkolla fetare (huze) dhe universiteti.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Një nga punët më të rëndësishme në fushën teorike, është të prezantojmë studimin mbi drejtësinë, si një degë të veçantë shkencore, brenda shkollës fetare dhe universitetit. Kjo, sot, nuk ekziston, as në shkollën fetare, as në universitet. S’ka

59 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

asnjë problem që në shkollën fetare të mendohet se një nga temat që mund të trajtohet nga një jurist (fakijh) apo përmes një metode juridike, është çështja e drejtësisë... Pse të mos ketë, në seminarin islam, një fushë të veçantë, ku juristi ta trajtojë drejtësinë në kuadër të mësimeve juridike deduktive (fikh i argumentuar) që ai jep?”⁶⁰

Së dyti, një teori që përbëhet nga koncepte të përgjithshme, mund të mbetet larg zbatimit praktik, nëse nuk shoqërohet me tregues të qartë për zbatimin e saj.

Prandaj, krahas kërkimeve teorike dhe themeluese për drejtësinë, në aspektin e konceptit dhe bazave të saj teorike, duhet të përcaktohen edhe treguesit praktikë dhe standardet e zbatimit të kësaj teorie në fusha të ndryshme të jetës shoqërore.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Një nga punët teorike më të rëndësishme që duhet ta bëjmë, është të zbulojmë treguesit e drejtësisë. Tani, treguesit që Perëndimi i propozon sot, janë të pranueshëm me disa kushte; disa prej tyre nuk janë tregues të mirëfilltë, disa janë të mangët dhe disa të tjerë mund të jenë të pranueshëm vetëm në rrethana të caktuara. Ne duhet të ulemi dhe, në mënyrë të pavarur, të nxjerrim treguesit e drejtësisë dhe të shtrirjes së saj në shoqëri. Kjo është një nga pikat më të rëndësishme të punës.

60 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

Natyrisht, ka shumë gjëra për të bërë edhe në fushën praktike. Një ndër to është që të vendosim drejtësinë si standardin bazë në legjislacion”.⁶¹

61 Nga fjalimi i Imam Khamenit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2011.

RINIA

Rëndësia e rinisë

Rinia përfaqëson elementin aktiv në të gjitha shoqëritë njerëzore; prandaj, asnjë shoqëri nuk ka jetë pa elementin e rinisë, përndryshe shoqëria do të shndërrohej në përtaci, plogështi dhe varësi nga të tjerët. Këtë të vërtetë e thekson edhe Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*), kur thotë: “Natyra e rinisë është e mbushur me shpresë, nismë, guxim, rrezikshmëri dhe këmbëngulje... këto elemente kanë vlerë për drejtimin e shoqërisë. Disa nga problemet tona burojnë nga mungesa e guximit për të rrezikuar, nga lodhja, nga mungesa e nismës, nga humbja e guximit ose nga dëshpërimi... këto (tipare negative) nuk gjenden tek të rinjtë”.⁶²

Nga ana tjetër, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka treguar se shpresa e çdo populli janë të rinjtë. Ai thotë: “Shpresa lidhet me të rinjtë; jo që të tjerët, ata që nuk janë të rinj, nuk kanë detyra në këtë rrugë, përkundrazi, edhe ata kanë përgjegjësitë e tyre, edhe pleqtë kanë detyrat e tyre. Ju

62 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2020.

e patë se Imami ynë i nderuar, Khomeini, edhe në moshën e tij të pjekurisë dhe pleqërisë, lëvizte si të rinjtë, fliste si të rinjtë dhe mendonte si të rinjtë. “Dinamoja” lëvizëse në çdo shoqëri janë të rinjtë”.⁶³

Në një fjalë tjetër, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) e thekson energjinë e dhuruar që e dallon rininë: “Energjia më e rëndësishme dhe më ngjallëse e shpresës janë energjitë njerëzore, të talentuara dhe të afta, të cilat mbështeten në një bazë të fortë dhe të thellë besimi fetar”.⁶⁴

Disa këshilla për të rinjtë

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka dhënë shumë këshilla sjelljeje, morale dhe praktike për të rinjtë, të cilat i ndihmojnë ata në ndërtimin e personalitetit të tyre njerëzor dhe islam. Këto këshilla janë:

1- Aspektet e ndërtimit të personalitetit të rinisë

Ndërtimi i personalitetit të të rinjve duhet të jetë i plotë nga katër anë, të cilat Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) i ka theksuar:

63 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.10.2019.

64 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 11.02.2019.

- a- Ana shpirtërore;
- b- Ana trupore;
- c- Ana shkencore;
- d- Ana administrative dhe praktike.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka thënë: “Le të përgatiten nga ana shpirtërore, nga ana trupore, nga ana shkencore dhe nga ana e aftësive administrative”.⁶⁵

2- Ndërtimi i vetes, në nivel individual dhe shoqëror

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Ndërtimi i vetes është jashtëzakonisht i rëndësishëm, si në përmasën individuale, ashtu edhe në atë shoqërore. Duhet të ndërtoni veten tuaj si individë dhe po ashtu ta ndërtoni veten si një grup. Miqësia me Kur’anin, lidhja me Kur’anin, falja e namazit me përqendrim zemre, falja e namazit në kohën e parë dhe kujdesi ndaj lutjeve, janë gjëra që unë i konsideroj të domosdoshme për ndërtimin e vetes. Këto do t’ju ndihmojnë ta kaloni me lehtësi dhe siguri rrugën me pengesa.

65 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 18.02.2019.

Ka pengesa: frika është pengesë, hezitimi është pengesë, ndjenja e dobësisë është pengesë, motivimet e pasakta janë pengesë... Në rrugën tonë ka shumë pengesa, sidomos për ata që merren me çështje shoqërore. Për këtë arsye, këta kanë më shumë nevojë për ndërtimin e vetes dhe për forcimin e strukturës së tyre shpirtërore e morale. Sipas mendimit tim, kur struktura juaj shpirtërore e morale është e fortë, do të gjeni më shumë aftësi, si në fushën e mendimit, ashtu edhe në marrjen e vendimeve dhe në veprim. Këto janë gjëra që i duam në brezin e rinisë”.⁶⁶

3- Forcimi i themeleve njohëse dhe shmangia e turbullirës dhe largimit

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Mjediset rinore, si universitetet, kanë pësuar dëme që prej kohësh. Ndër dëmet kryesore që janë përqendruar në mjediset rinore, janë dy: turbullira dhe largimi. Turbullirë do të thotë ndjenja se je i lidhur duarsh, i padobishëm dhe i dëshpëruar përballë ngjarjeve të vështira, gjë që mund të kapërcehet, kur ngrihet niveli i moralit; atëherë nuk do të ketë aspak turbullirë. Ndërsa largimi, largimi ideor, largimi nga themelet njohëse, trajtohet përmes kësaj këshille.

66 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2020.

Shikoni, kemi pasur të rinj në ditët e para të revolucionit, ishin njerëz myslimanë dhe hynë në fushë për hir të Islamit. Mirëpo, për shkak se themelet e tyre njohëse ishin të dobëta, ata u tërhoqën nga grupe të humbura dhe u shndërruan nga të rinj besimtarë, të shëndoshë e islamikë, në ata që ngritën armën kundër vëllezërve të tyre bashkëqytetarë. Ata, në sulmet e tyre synuan të rinjtë, pleqtë, tregtarët në treg dhe kryen mizori e krime. Për shkak të dobësisë në themelet njohëse, ata u tërhoqën drejt këtyre grupeve të devijuara, u shtrinë në këto rrugë dhe në fund u vunë nën flamurin e Sadamit. Burimi i gjithë kësaj ishte mungesa e themelit arsyetues.

Në atë kohë, para revolucionit, kishte edhe njerëz të tjerë, ne i njihnim ata, unë njihja shumë nga këta njerëz, në organizata, grupe të ngjashme, të cilët qëndruan me vendosmëri, sepse themelet e tyre arsyetuese ishin të sakta. Ata ishin të lidhur me librat e dëshmorit Mutahari, ishin të njohur me idetë e Allame Tabatabait dhe fjalët e dëshmorit Sadr. Themelet e tyre arsyetuese dhe njohëse ishin të forta, prandaj ata qëndruan me vendosmëri, ndërsa disa të tjerë, që kishin themele të dobëta njohëse, fatkeqësisht u tërhoqën”.⁶⁷

4- Vazhdimi i kërimit të vlerave ideale dhe llogaridhënies

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thekson domosdoshmërinë e mbajtjes së vlerave ideale, duke thënë: “Mos e lini flamurin e kërimit të vlerave ideale dhe të llogaridhënies. Kjo është gjë shumë e çmuar. Disa gjëra që ju kërkon, mund të mos jenë të zbatueshme dhe ky është realiteti i çështjes; domethënë, kur njeriu nis punën, vështirësitë praktike bëhen më të qarta për të dhe del në pah se gjithçka që kemi dashur ose nuk mund të realizohet, ose nuk mund të realizohet për një kohë të afërt. Por vetë kërkitimi i vlerave dhe synimeve ideale është shumë i çmuar, sepse, nëse nuk ka kërkitim për vlera dhe synime ideale, atëherë do ta humbim rrugën. Kërkitimi i vlerave dhe synimeve ideale na bën të mos e humbim rrugën dhe të mos shmangemi as majtas, as djathtas në mes të saj. Mbajeni fort këtë kërkitim për vlerat dhe synimet ideale. Këto vlera ideale janë: drejtësia, pavarësia, shuarja e korrupsionit dhe, në fund të fundit, ndërtimi i qytetërimit islamik...

Qëllimi kryesor, i vërtetë dhe përfundimtar është ndërtimi i qytetërimit islamik. Mos i humbni këto vlera, kërkojini dhe kërkonit të mendoni rreth tyre”.⁶⁸

Në një fjalë tjetër, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thekson domosdoshmërinë e vazhdimit të përsosjes,

68 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2020.

mospasjen e frikës dhe mbajtjes larg të dëshpërimit. Midis të tjerash, thotë: “O të rinj, ushqeni brenda vetes dhe brenda të tjerëve filizat e shpresës për të ardhmen dhe përzini prej vetes dhe prej të tjerëve frikën e dëshpërimit. Ky është xhihadi juaj i parë dhe më i rëndësishmi”.⁶⁹

5- Kritika, së bashku me propozimin dhe shmangia e talljes

Në një këshillë tjetër, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka theksuar domosdoshmërinë e kritikës dhe të propozimit. Kritika jokonstruktive rrënon personalitetin dhe veprën. Ai thotë: “Llogaridhënia nuk është thjesht kritikë dhe as vetëm kundërshtim, edhe pse përfshin kundërshtim, por është kritikë, së bashku me propozim. Një grup të rinjsh që dëgjojnë këtë fjalë dhe veprojnë në këto fusha, duhet t’i kushtojnë vëmendje faktit se, nëse vetëm kritikojmë dhe vetëm kundërshtojmë, kjo nuk do të sjellë dobi. Në këtë mënyrë, as kundërshtimet nuk do të jenë të dobishme dhe nuk do të kenë ndikim të qëndrueshëm. Po, mund të ketë disa përfitime të vogla në fillim, por ajo që është vërtet e dobishme, është propozimi. Shikoni, edhe në Islam ndalesa nga e keqja është e shoqëruar me urdhrin për të mirën. Ndalesa nga e keqja është vetë kundërshtimi, ndërsa urdhri për të mirën nënkupton propozimin, ofrimin

69 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 11.02.2019.

e një zgjidhjeje dhe tregimin e veprës që duhet bërë dhe mund të zbatohet. Këto të dyja vijnë së bashku. Prandaj, bëni llogaridhënie gjithmonë të shoqëruar me propozime dhe paraqitni zgjidhje të mira dhe të pranueshme. Si rikujtim, mos e shoqëroni kurrë llogaridhënien me tallje dhe sharje. Ky është lutja ime për ju”.⁷⁰

6- Përfitimi nga njerëzit me përvojë

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka theksuar domosdoshmërinë që të rinjtë të përfitojnë nga ata që kanë përvojë të mëparshme dhe zotërojnë dije të gjera. Të rinjtë duhet të punojnë me këtë kategori të shoqërisë, për t’i shërbyer popullit dhe për të zhvilluar vendin. Ai ka thënë: “Unë gjithmonë mbështetem te të rinjtë, por kjo nuk do të thotë të mbyllim sytë para individëve me përvojë, dije dhe profesionalizëm. Të rinjtë, në fakt, janë pararendësit kryesorë, ata që nxisin dhe shtyjnë përpara. Prandaj, prania e tyre është e domosdoshme, qoftë në institucionet shtetërore, qoftë në institucionet ligjvënëse apo në sektorët e tjerë të ndryshëm. Kjo frymëmarrje rinore, për të cilën kemi folur, është një domosdoshmëri e vërtetë për vendin, por kjo nuk nënkupton përjashtimin e njerëzve me përvojë,

70 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2020.

profesionistëve dhe ekspertëve. Jo. Kombinimi mes këtyre dy kategorive është kombinim i dëshiruar”.⁷¹

7- Kontrolli i ndjenjave

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka theksuar domosdoshmërinë e vëmendjes ndaj ndjenjave dhe kontrollit të tyre, si dhe drejtimin e tyre sipas sistemit ligjor dhe moral islam. Ai ka thënë: “Duhet të kemi parasysh se ne mbështetemi te të rinjtë dhe u besojmë atyre, por nuk është e drejtë që ndjenjat e të rinjve të mbizotërojnë shoqërinë, në mënyrë absolute dhe të pakontrolluar. Ndjenjat duhet të mbahen nën kontroll. Mund të veprohët në dy mënyra: e para, të përballemi me emocionet, pa asnjë kontroll; dhe e dyta, të sillemi me emocionet në atë masë që është e nevojshme për t’u shfaqur. Kjo nuk është një çështje e lehtë”.⁷²

8- Rëndësia e krijimit të diskursit

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Mjafton që të rinjtë të thonë diçka, të përhapet dhe ta dëgjojnë një grup të rinjsh apo edhe jo të rinj, dhe kjo dalëngadalë ndërton një

71 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 18.02.2020.

72 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 14.03.2019.

mendësi të re. Pikërisht këto mendësi janë krijimi i diskursit. Kjo prodhon atë që quhet orientim i caktuar ideor në shoqëri, gjë që ka vlerë të madhe. Shpresa ime për ju është që lëvizjet studentore t'i kushtojnë rëndësi krijimit të dialogut. Nxirrni çështjet e sistemit, mendoni mbi to, ofroni zgjidhje të studiuar dhe të fuqishme, dhe shtrojeni ato çështje. Gjithashtu, duhet që mendimet e të rinjve dhe ajo që ata propozojnë, të merren parasysh, t'u kushtohet rëndësi dhe mbi këtë bazë të krijohet diskursi në shoqëri. Me krijimin e një diskursi të tillë, do të lindë prirja e përgjithshme e popullit drejt grupeve rinore”.⁷³

9- Kujdesi dhe vigjilenca ndaj përpjekjeve të armikut për t'ju rekrutuar

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka tërhequr vëmendjen se armiku i kushton rëndësi të veçantë rinisë, me qëllim shkatërrimin e saj dhe të ardhmes së saj, shkatërrimin e energjive rinore, dhe në përfundim, shkatërrimin e vendit, dhe të rolit të tij në botë. Ai thotë: “Vetë të rinjtë dhe ata që merren me çështjet e rinisë, duhet ta dinë se, ashtu siç ne i kushtojmë rëndësi rinisë për të ardhmen dhe përparimin e vendit, po ashtu edhe armiku ynë i kushton rëndësi rinisë,

73 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2020.

por për ta shkatërruar vendin dhe për ta gjuhëzuar revolucionin. Ai e njih mirë rolin e të rinjve.

Duhet të jemi të gjithë të vetëdijshëm se armiqtë po punojnë mbi rininë tonë, duke u përpjekur të përfitojnë prej saj në mënyrë të dëmshme dhe e ndjekin këtë me plane dhe strategji. Ndonjëherë atyre u duhen elemente brenda vendit, prandaj veprojnë mbi të rinjtë që janë këtu; ndonjëherë u duhen elemente propagandistike, analistë politikë apo figura politike, prandaj veprojnë mbi ta; ndonjëherë, për shembull, kërkojnë ta detyrojnë një të ri t'i kthejë shpinën ndaj atdheut të tij dhe të largohet. Unë e kam parë këtë të ndodhë. Ata i detyrojnë artistët, sportistët, studentët e seminareve fetare, që nuk e kanë përfunduar ende mësimin e tyre, studentët universitarë, i shtojnë në një mënyrë a tjetër, me shumë zhurmë mediatike, ta braktisin vendin. Të gjitha këto janë gjëra që armiku po i bën aktualisht me rininë. Prandaj, të gjithë duhet të jenë vigjilentë dhe të kujdesshëm, të mos ndihmojnë, qoftë edhe pa dashje, në rekrutimin e rinisë nga armiku.

Objektivi i parë që synon armiku, është mendimi juaj, mënyra e të menduarit dhe çfarë sundon mbi mendjen tuaj. Ky është objektivi i parë. Armiqtë, me lloj-lloj dredhish e mashtrimesh, përpiqen t'i ndryshojnë këto mendime. Kur mendimet ndryshojnë, edhe veprimet do të ndryshojnë në mënyrë të natyrshme. Mos lejoni që mendimet të ndryshohen, mos lejoni që të dobësohen motivet dhe nxitjet

tuaja, mos lejoni që armiku të shuajë forcën e brendshme të besimit dhe vendosmërinë tuaj. Qëndroni të fortë dhe të patundur, mbështetuni te Zoti dhe Zoti i Lartësuar do të jetë me ju, nëse do Allahu”.⁷⁴

10- Të vepruarit me sinqeritet

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Ne dëshirojmë që të rinjtë tanë të veprojnë me sinqeritet, ashtu si në periudhën e “Mbrojtjes së shenjtë”, kur ata, me të vërtetë, ishin të tillë. Ata që morën pjesë në atë periudhë, sakrifikuan dhe vepruan me sinqeritet dhe përkushtim. Falë kësaj, arritën të ecin përpara, pastaj vazhduan më pas në të njëjtin drejtim në fusha të ndryshme. Vrapimi pas sukseseve materiale pengon punën dhe prania e atyre që kryejnë punët për qëllime tokësore, për të arritur pasurinë, pozitën, famën dhe gjëra të ngjashme, është diçka që pengon përparimin, sepse puna përparon vetëm me luftë shpirtërore dhe me sinqeritet”.⁷⁵

74 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2020.

75 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 12.10.2020.

Rekomandime për përgjegjësit, lidhur me rininë

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) , në shumë fjalime të tij ka theksuar disa këshilla që duhet të zbatohen nga përgjegjësit dhe udhëheqësit e Republikës Islamike, në lidhje me rininë. Ato janë:

1- Drejtimi kah të rinjtë dhe këshillimi i tyre

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) nxit për domosdoshmërinë e vëmendjes ndaj brezit të ri, kujdesit ndaj tij dhe tërheqjes së tyre drejt shpirtërores, sepse rinia zotëron një natyrë të pastër dhe të qartë hyjnore. Ai thotë: “Rruga e tërheqjes së të rinjve është përmes fitimit të zemrave të tyre. Zemrat e të rinjve janë të habitshme, gjendja e tyre është jashtëzakonisht e mahnitshme. Drejtimi dhe tërheqja e tyre kah shpirtërorja është një nga sekretet më të mëdha hyjnore. Nëse unë, robi i Zotit, dëgjoj një fjalë shpirtërore e hyjnore, ndoshta në rastin më të mirë prekem pak, por, kur e njëjta fjalë i thuhet një të riu, ai përmbysset dhe transformohet nga një gjendje në tjetrën. Zemra e të riut është e hapur ndaj të vërtetës, ajo është afër natyrës hyjnore: **“...natyrën fillestare (el fitratu), në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit”**.⁷⁶

76 Sure “Er Rrum”, ajeti 30.

Zemra e të riut gjen ngushëllim te këshillat dhe çështjet shpirtërore, morale e mistike. Ajo lidhet shpejt, dashurohet e përfshihet shpejt. Kjo është ajo që i tërheq të rinjtë. Përziejeni fjalën dhe veprën tuaj me shpirtëroren dhe me irfanin e vërtetë, jo me lloje të irfanit imagjinar, iluzor e sipërfaqësor dhe do të shihni se si të rinjtë do të tërhiqen dhe do të afrohen pas këtyre çështjeve”.⁷⁷

2- Kujdesi ndaj elitave të reja

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Të gjithë përgjegjësit duhet të kujdesen për elitat, si një detyrim. Këtu kemi një objektiv madhor, i cili kërkon që shikimi ndaj elitave të jetë serioz, praktik, me mëshirë, kujdes dhe ndjekje të vazhdueshme. Cili është ky objektiv? Ai është shndërrimi i Iranit në një vend të përparuar dhe fisnik, fisnik në përballje me vende të ulëta e të liga, siç janë disa shtete dhe fuqitë e sotme, dhe në një vend që mbart ide të reja në çështjet njerëzore dhe botërore”.⁷⁸

77 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 21.08.2016.

78 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 19.10.2016.

3- Transformimi në vështrimin ndaj brezit të ri dhe besimi tek ai

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Bëhuni si Imami Khomeini! Imami kishte besim në mendimin dhe veprimin e të rinjve. Ky ishte një transformim, në kuptimin e plotë të fjalës. Merrni si shembull Korpusin e Gardës së Revolucionit Islamik, i cili u formua. Imami pranoi që të rinj rreth të njëzetave të vendoseshin në krye të Gardës. Shumica e tyre ishte rreth të tridhjetave. Ata ishin komandantë të Gardës së Revolucionit, drejtues të brigadave dhe korpuseve. Të gjithë këta ishin të rinj, që u ngarkuan me detyra madhore. Po kështu ndodhi edhe në fusha të tjera, në çështje gjyqësore dhe fusha të tjera. Imami kishte një besim të habitshëm te të rinjtë, duke i konsideruar ata të denjë për përgjegjësi dhe duke iu besuar punët. Ai i besonte mendimit dhe veprimit të tyre”.⁷⁹

4- Dështimi i planeve të armikut për dobësimin e moralit të njerëzve

Imami Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka theksuar domosdoshmërinë e vëmendjes ndaj planeve të armikut, metodave dhe mjeteve që ai përdor për të shkatërruar moralin e njerëzve në përgjithësi dhe të të rinjve në veçanti.

79 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.06.2019.

Midis të tjerash, thotë: “Politika e dobësimit të moralit të njerëzve, të lëvizjes, të aktivitetit dhe të shpresës tek ata, ka ekzistuar që në fillim të Revolucionit. Kjo ka qenë metoda e pandryshueshme që ka ndjekur armiku: të përpiqet të ndikojë te populli përmes televizioneve dhe radiove të drejtuara prej tij, duke i bërë ata të mendojnë se janë të mjerë, se gjendja e tyre është e keqe, se punët e tyre kanë marrë fund, dhe askush nuk mund t’u vijë në ndihmë, e të tjera gjepura të tilla... Pse e bëjnë këtë? Që të dobësojnë moralin e njerëzve dhe t’ua marrin shpresën, sidomos të rinjve, sepse, kur i riu është i mbushur me shpresë, lëvizja e tij bëhet e jashtëzakonshme. Të rinjtë janë gjithmonë pararendës dhe prijës, por, nëse u merret shpresa, ata ndalen nga lëvizja”.⁸⁰

5- Kujdesi për çështjet e edukimit moral dhe bukurinë shpirtërore të të rinjve

Imami Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Duhet t’i përpunojmë shpirtat e të rinjve tanë të dashur. Këta të rinj që janë këtu, janë bijtë tanë të dashur, janë shpirtra të mirë dhe zemra të shëndosha në shoqërinë tonë. Këta të rinj janë shtresa më e mirë e popullit dhe e shoqërisë sonë. Prandaj, sa të jetë e mundur, duhet të punojmë për të siguruar mjetet

80 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 31.07.2020.

e nevojshme për përpunimin e shpirttrave të tyre. Bukuria e tyre shpirtërore qëndron te pajisja me devotshmëri, singëritet, guxim, përlësi, besnikëri ndaj premtimit dhe zbatimi i fjalës që kanë dhënë ndaj sistemit, Islamit dhe revolucionit. Këto janë nga virtytet më të rëndësishme shpirtërore, me të cilat duhet ta stolisin veten. Të gjithë duhet t’u kushtojnë vëmendje këtyre aspekteve, në mënyrë që bota të mos i mashtrojë të rinjtë tanë dhe të mos i tërheqë ata drejt grumbullimit të pasurisë, pozitës dhe famës, nëse marrin ndonjë përgjegjësi”.⁸¹

Këtu Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thekson se vepra më e rëndësishme është ndërtimi i njeriut, sidomos i të rinjve, duke thënë: “Fitorja më e madhe që arriti ky revolucion, është edukimi i të rinjve dhe përgatitja e këtyre filizave të gjallë. Këtë e pati thënë një herë Imam Khomeini dhe ai kishte të drejtë. Fjalët e tij ishin plotësisht të sakta. Kjo është urtësia e Imamatit, sepse të gjitha fitoret, veprat dhe arritjet e tjera të rëndësishme janë të vogla përballë kësaj arritjeje: edukimit të individëve të veçantë. Dhe, për fat të mirë, sot ne kemi shumë prej këtyre individëve”.⁸²

81 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 12.10.2020.

82 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 08.01.2020.

6- Vlerësimi i energjisë së të rinjve dhe shfrytëzimi i tyre

Udhëheqësit në Republikën Islamike duhet t'u kushtojnë vëmendje mundësive të të rinjve dhe t'i çmojnë ato. Kjo arrihet përmes njohjes së këtyre mundësive dhe energjive të mëdha, me të cilat dallohen të rinjtë. Imami Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: "Ndër këto mundësi dhe energji janë këta të rinj të mirë. Ka nyje që pengojnë punën e disa përgjegjësve në disa sektorë të institucioneve të mëdha qeveritare dhe zyrtare, dhe këta të rinj mund t'i zgjidhin e t'i lirojnë ato, qoftë me gishtat e mendimeve të tyre të ndritura rinore, qoftë me gishtat e punës dhe përpjekjeve të tyre. Le ta njohin vlerën e të rinjve, le t'u drejtohen atyre dhe të përfitojnë nga mendimet e tyre. Shpesh kemi qenë të suksesshëm pikërisht kur kemi përfituar nga idetë e tyre. Le ta njohim vlerën e të rinjve dhe të dëshirave të tyre të larta. Të rinjtë janë ambiciozë. Ky nuk është problem. Pikërisht këto dëshira janë ato që e shtyjnë popullin përpara dhe e pengojnë të ngecë e të ndalet. Ata nuk frikësohen nga zhurma dhe propaganda e perëndimorëve".⁸³

Imami Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka theksuar se e ardhmja e ndritshme u përket të rinjve: "Sigurisht, e

83 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 09.01.2019.

ardhmja është e juaja, o të rinj. Ky vend është i juaji. Le t'i ndërtojnë të rinjtë vetveten.”⁸⁴

Lutja ime për të rinjtë

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Unë gjithmonë lutem për të rinjtë, pa ndërprerje. Unë lutem për ju, o të rinj, të paktën një herë në ditë. Lutem që Allahu t’ju ndihmojë, t’ju udhëzojë, t’ju bëjë të lumtur, t’ju zgjidhë problemet; problemet e punës, të martesës dhe problemet e ndryshme që keni. Shpresoj që Allahu t’i pranojë këto lutje, dhe padyshim do t’i pranojë. Sigurisht, e ardhmja e shoqërisë sonë të re do të jetë më e mirë se e sotmja, me ndihmën hyjnore dhe me begatitë e virtyteve të Imamit të Zamanit, Mehdiu, (Shpirtrat tanë u flijofshin për të!)”.⁸⁵

Në një fjalim tjetër, Imami Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka thënë: “Ju jeni si bijtë e mi, në kuptimin më të plotë të fjalës. Unë dëshiroj për ju atë që dua për fëmijët e mi. Unë gjithmonë lutem për ju. Nuk kalon natë apo ditë pa u lutur për ju, o të rinj dhe kërkoj nga Allahu i Lartësuar t’ju forcojë në këtë rrugë. Dhe ta dini se, nëse qëndroni të palëkundur

84 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 18.02.2018.

85 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 17.05.2020.

në këtë rrugë, atëherë do të përmirësohet vendi, do të përmirësohet bota dhe do të përmirësohet njerëzimi”.⁸⁶

86 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 19.10.2019.

LIRIA

Hyrje

Ekziston një lidhje e ngushtë mes koncepteve kulturore që ndikojnë në shoqëri, nga njëra anë dhe lëvizjes së saj politike, shoqërore dhe ekonomike, nga ana tjetër, një lidhje që nuk mund të ndahet. Për këtë, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) , duke shpjeguar natyrën e kësaj ndërlidhjeje dhe burimet e saj, thotë: “Lëvizja kulturore, në çdo qytetërim apo shoqëri, nuk është e ndarë nga ngjarjet politike dhe zhvillimet që ndodhin në jetën reale të njerëzve dhe të bashkësisë. Kërkimet që lidhen me vlerat, si p.sh. liria, prekin drejtpërdrejt jetën e shoqërisë, aq sa është e vështirë që një bashkësi të mblidhet apo të organizohet rreth një mendimi, pa e ditur me qartësi qëndrimin e atij mendimi ndaj vlerave. Shkaku i përgjithshëm është se studimet strukturore dhe themelore, që të nisin, kanë nevojë për një ngjarje nxitëse. Pra, zakonisht duhet të ndodhë ndonjë ‘stuhi’ që të nxitet diskutimi mbi çështje të thella dhe sfiduese si këto. Këto kërkime nuk fillojnë në rrethana normale; duhet të ketë një ngjarje që t’i hapë rrugën”.⁸⁷

87 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

Në mendimin perëndimor, vërehet një rritje e ndjeshme e interesit për konceptin e lirisë, e cila konsiderohet si një nga vlerat themelore të përqafuara nga Evropa, pas Revolucionit Industrial dhe Revolucionit Francez. Prandaj, konteksti historik i lindjes së interesimit për këtë vlerë është i qartë. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) sqaron: “Perëndimi, gjatë këtyre tre apo katër shekujve të fundit, që përkojnë me epokën e Rilindjes dhe periudhës pas saj, ka përjetuar një zhvillim dhe lulëzim të paprecedentë. Pak tema, si çështja e **lirisë** janë trajtuar kaq gjerësisht në këto katër shekuj, qoftë në shkencat filozofike, shoqërore, art apo letërsi. Kjo ka një shkak të përgjithshëm kryesor dhe edhe disa arsye rrethimore”.⁸⁸

Ngjarja qytetëruese themelore që nxiti diskutimet për lirinë në Perëndim, ishte shfaqja e epokës së Rilindjes, pas epokës së errët (mesjetës), siç e quajnë vetë ata. Mbi këtë bazë, Imami thotë: “Faktorët e rritjes së kësaj lëvizjeje mendore janë si më poshtë: në radhë të parë, epoka e Rilindjes, nuk ndodhi menjëherë. Në fakt, ndodhën shumë ngjarje për gjatë dy shekujve të parë të kësaj epoke, si Revolucioni Industrial dhe Revolucioni i madh Francez. Të gjitha këto çuan në trajtimin e çështjes së lirisë. Për këtë arsye, u punua shumë mbi të. Filozofë të shumtë shkruan mijëra studime, artikuj dhe libra, dhe u hartuan qindra vepra, në lidhje me lirinë në të gjitha vendet perëndimore.

88 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

Më pas, ky mendim kaloi në Amerikë, ku u punua në të njëjtën mënyrë”.⁸⁹

Nisur nga kjo pikëpamje, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) vëren se prirja e Rilindjes dhe kërkimi për lirinë në Perëndim kishte si bazë armiqësinë ndaj kishës. Ai sqaron: “Prirja e epokës së Rilindjes, në thelb, ishte një prirje armiqësore ndaj fesë dhe kishës. Për këtë arsye, ajo u themelua mbi Humanizmin (humanizëm laik). Më pas, të gjitha lëvizjet perëndimore u ndërtuan mbi këtë parim dhe kanë vazhduar kështu deri në ditët tona. Edhe pse kanë ndodhur shumë ndryshime, themeli ka qenë gjithmonë humanizmi, d.m.th. mosbesimi dhe politeizmi”.⁹⁰

Nga këtu, çdo studiues që dëshiron të hyjë në diskutimin e koncepteve dhe vlerave si liria, duhet të vërejë me kujdes se disa ide janë formuar apo janë mbështetur nga qëllime dhe plane të rrezikshme dhe shkatërruese. Prandaj, është detyrë e studiuesve nga ambienti dhe kultura jonë, që të kthehen tek burimet islame.

Këtë e thekson Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*), kur thotë: “Burimet tona janë të shumta. Ne nuk jemi të varfër me burime. Realisht, ne mund të ndërtojmë një korpus të plotë mendimi dhe një sistem të plotë ideor në fushën e lirisë, që u përgjigjen të gjitha pyetjeve të detajuara dhe të

89 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

90 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

përgjithshme për këtë temë. Sigurisht, kjo nuk është një punë e lehtë, kërkon përkushtim dhe përpjekje të madhe”.⁹¹

Elementet e kërimit rreth lirisë

1. Tema e lirisë

Koncepti i lirisë është një koncept me shumë degë dhe aspekte. Ai nuk kufizohet vetëm në një formë apo në një drejtim të vetëm, i lidhur me lëvizjen e njeriut. Ekziston liria shpirtërore, liria shoqërore, ekonomike etj.

Për sa i përket çështjes së lirisë që po zhvillojmë sot diskutimin, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) e sqaron duke thënë: “Në thelb, diskutimi ynë nuk ka të bëjë me lirinë shpirtërore, e cila nënkupton ecjen drejt Allahut, afrimin me Të dhe përshkrimin e rrugës së njësimi të Zotit (teuhidit), rrugë që ka prodhuar figura, si: Mulla Husen Kal’lij El Hemedani, ose i ndjeri Sejid Mirza Kadhi apo dijetari i madh Al’lame Tabatabai.

Diskutimi ynë ka të bëjë me liritë shoqërore dhe politike, me liritë individuale dhe kolektive, sepse kjo është çështja aktuale në botën e sotme”.⁹²

91 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

92 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) , gjithashtu, tregon se është e mundur që kuptimi i lirisë shpirtërore të zgjerohet, në mënyrë që të përfshijë diskutimin për të si vlerë shpirtërore dhe shoqërore. Ai thotë: “Ne kemi dy kuptime për termin ‘liri shpirtërore’:

Kuptimi i parë është ai që nënkupton ngjitjen drejt Allahut, afërsinë me Të, dashurinë për Allahun dhe të ngjashme. Kjo nuk hyn fare në diskutimin tonë; ajo ka vendin e vet të veçantë.

Kuptimi i dytë është liria shpirtërore, në kuptimin e çlirimit nga prangat e brendshme, ato që më pengojnë të shkoj drejt xhihadit, të përballem, të flas hapur, të shpreh qëndrimet e mia në publik dhe më bëjnë të jem hipokrit dhe dyfytirës. Pra, çështja e përballjes me pengesat e lirisë është një çështje që mund të trajtohet dhe të diskutohet”.⁹³

2- Liria në Islam

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) tërheq vëmendjen ndaj një gabimi që bëjnë shumë njerëz në mënyrën se si i qasen konceptit të lirisë. Ai thotë: “Qasja e gabuar islame ndaj çështjes së lirisë është kur e vendosim lirinë si një vlerë absolute përballë të gjitha vlerave të tjera dhe pastaj fillojmë

93 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

të kërkojmë përjashtime dhe kufizime. Si për shembull: themi që në bazë jemi të lirë, në mënyrë absolute, përveç atyre rasteve që Islami i ka përjashtuar. Këtë gabim mund ta bëjë dikush, kur i qaset diskutimit mbi lirinë. Më pas vijon: “Unë them se çështja nuk është kështu. Që në fillim, nuk ekziston ndonjë supozim i mëparshëm që dëshiron të na japë liri absolute. Ne, që në fillësë, nuk kemi një supozim të tillë, që liria absolute është një e drejtë e njeriut dhe e lidhur me natyrën e tij apo që është një vlerë, në vetvete, për të. Pikënisja jonë në trajtimin e lirisë në Islam është që të themi: ‘në Islam’, që do të thotë se ne i vendosim lirisë një kuadër që nga fillimi dhe ia përcaktojmë kufijtë që në hapin e parë”.⁹⁴

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) shpjegon bazën e parë mbi të cilën ndërtohet koncepti i lirisë në Islam, duke thënë: “Gjëja e parë që Islami ndërton në diskutimin rreth lirisë, është pranimi i ekzistencës së kufizimeve për këtë liri absolute, që disa e kanë supozuar. Këto kufizime, në mënyrë themelore, janë hallalli dhe harami (e lejuara dhe e ndaluara).

Në ajetin 157 të sure “El A’raf”, Allahu thotë:

﴿الَّذِينَ يَتَّبِعُونَ الرَّسُولَ النَّبِيَّ الْأُمِّيَّ الَّذِي يَجِدُونَهُ مَكْنُوزًا عِنْدَهُمْ فِي الْتَوْرَةِ وَالْإِنْجِيلِ يَأْمُرُهُم بِالْمَعْرُوفِ وَيَنْهَاهُمْ عَنِ الْمُنْكَرِ وَيُحِلُّ لَهُمُ الطَّيِّبَاتِ وَيُحَرِّمُ عَلَيْهِمُ الْخَبَائِثَ وَيَضَعُ عَنْهُمْ إِصْرَهُمْ وَالْأَغْلَالَ الَّتِي كَانَتْ عَلَيْهِمْ﴾

94 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

“Ata që ndjekin të Dërguarin, Profetin analfabet, të cilin e gjejnë të përshkruar tek ata në Teurat dhe Inxhil, ai i urdhëron për të mirën dhe i ndalon nga e keqja, ua lejon atyre të mirat dhe ua ndalon të shëmtuarat, dhe ua heq barrët e rënda dhe prangat që kishin mbi vete”.

Ky është ajeti më i qartë në Kur'an për lirinë, sepse flet për heqjen e barrës. Fjala *“isr”-“barrë”*, në arabisht i referohet atyre litarëve me të cilët lidhet fort çadra në tokë, që të mos e rrëzojë era, ato që janë lidhur fort me tokën. Kjo është *“lidhja me tokën”*, gjendja e ngjitjes së njeriut pas saj. Pengesat që kemi, janë ato që na mbajnë të lidhur me tokën dhe nuk na lejojnë të fluturojmë (shpirtërisht, moralisht). Ndërsa fjala *“al ghil’lu”- “pranga”* i referohet zinxhirëve metalikë. Profeti erdhi për t’i hequr ato nga njerëzit.

Në këtë ajet, para se të thuhet: *“Dhe ua hoqi atyre barrët dhe prangat që kishin mbi vete”*, thuhet: *“Dhe ua lejoi të mirat dhe ua ndaloi të këqijat”*. Çfarë do të thotë hallalli dhe harami? Do të thotë vendosje kufijsh dhe ndalimesh. Këto janë gjithmonë të lidhura me idenë e ndalimit. Prandaj, që në fillim, nuk duhet ta përjashtojmë në mendjen tonë ekzistencën e kufijve dhe ndalesave, kur flasim për lirinë”.⁹⁵

“Supozimi i ekzistencës së asaj që quhet ‘liri absolute’ si një parim, vjen nga një pikëpamje joislame ndaj

95 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

ekzistencës, një pikëpamje që e vendos njeriun në qendër të gjithçkaje dhe jo Allahun e Lartësuar. Por, nëse e shikojmë çështjen nga këndi islam, do ta shohim qartë dallimin mes liberalizmit dhe Islamit në çështjen e lirisë.

Dallimi më i rëndësishëm është se burimi i lirisë në liberalizëm – qoftë si ‘e drejtë’ apo si ‘vlerë’, është tendenca humaniste, sepse në atë sistem, njeriu është qendra e ekzistencës dhe i zgjedhjeve në botë.” Ata (në mendimin liberal) thonë se njeriu është në qendër, domethënë Zoti i kësaj bote, në kuptimin filozofik, është vetë njeriu. Dhe kjo botë nuk mund të kuptohet pa lirinë e njeriut, për të zgjedhur dhe për të pasur vullnet të lirë.

Pra, nëse njeriu nuk ushtron vullnetin e tij (që është kuptimi tjetër i lirisë), atëherë nuk mund të mendohet si qenie zgjedhëse dhe me vlerë në këtë botë. Kjo është baza e diskutimit për lirinë në mendimin liberal dhe ky është themeli i mendimit humanist (humanizmit laik) për lirinë. Ndërsa në Islam, çështja është krejtësisht ndryshe.

Në Islam, themeli mbi të cilin ndërtohet personaliteti dhe ekzistenca e njeriut është: teuhidi (njësimi i Allahut)”.⁹⁶

Teuhidi (Njësimi i Zotit), në kuptimin e tij të thellë, nuk nënkupton vetëm besimin në Allahun e Lartësuar, por

96 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

ka shtrirje të gjera në jetën njerëzore dhe në sistemin e vlerave.

Me fjalë të tjera: Teuhidi e ngjyros jetën e njeriut me një ngjyrë të tillë, që i jep atij një stil jete krejt të ndryshëm nga ai i një personi që nuk beson në Allahun si Zot të vetëm dhe të vetmuar.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thekson se koncepti i teuhidit nuk është i kufizuar vetëm në besimin në Zot, duke thënë: “Teuhidi nuk kufizohet në besimin në Allahun. Ai përfshin: besimin në Allahun, mohimin e tagutit (çdo autoritet që sfidon Zotin), adhurimin vetëm për Allahun dhe refuzimin e adhurimit ndaj kujtdo tjetër veç Tij. Ai citon ajetin kur’anor:

﴿فَمَنْ يَكْفُرْ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنْ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَى﴾

“Ejani te një fjalë e përbashkët mes nesh dhe jush: që të mos adhurojmë askënd përveç Allahut dhe të mos i shoqërojmë Atij asgjë”.⁹⁷ Ai vëren se ajeti nuk thotë “të mos i shoqërojmë Atij asnjë person”, por përdor fjalën “asgjë”, që ka kuptim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës.

Pra, nëse ndjek zakonin, pa asnjë provë apo logjikë, kjo bie ndesh me teuhidin. Nëse ndjek njerëzit në mënyrë të verbër, kjo, gjithashtu, është një lloj shoqërimi me Zotin

97 Sure “Al Imran”, ajeti 64.

(shirk). Po kështu, edhe kur ndjek sisteme shoqërore që nuk burojnë nga vullneti i Allahut, kjo konsiderohet si shirk, sepse çdo gjë që nuk përfundon te vullneti hyjnor, është shoqërim me Zotin. Prandaj, teuhidi është largimi nga ky shirk. Ai citon ajetin tjetër:

﴿تَعَالَوْا إِلَى كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا﴾

“Kush e mohon tagutin dhe beson në Allahun, ai e ka kapur lidhjen më të fortë”.⁹⁸ Vërejmë se, së pari, përmendet mohimi i tagutit, pastaj besimi në Allahun. Dhe vijon: “Epo, ky është kuptimi i lirisë së vërtetë: të jesh i lirë nga të gjitha prangat dhe varësitë, përveç adhurimit ndaj Allahut”.⁹⁹

Islami ka një vizion të thellë dhe të qartë, lidhur me konceptin e lirisë dhe përfshirjen e saj të gjerë. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) e shpjegon këtë duke thënë: “Nëse u referohemi burimeve tona islame, do të shohim se kuptimi i lirisë ka pasoja dhe shtrirje që lidhen me mënyrën se si njeriu e shikon Allahun dhe me gjithçka që rrjedh nga kjo pikëpamje: besimi në dynjanë dhe Ahiretin, vendosja e botës tjetër përpara kësaj bote, dhe braktisja e kësaj bote dhe refuzimi i të mirave të saj, përballë begatisë së përhershme të botës tjetër”.

⁹⁸ Sure “El Bekare”, ajeti 256.

⁹⁹ Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

Ai përmend një thënie të transmetuar nga Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*): “A nuk ekziston ndonjë njeri i lirë, që ta lërë këtë copë mbeturinë për ata që e duan atë? Kjo është liria...”

Dhe më pas, shton: “Vlera e vetme e vetes suaj është Xheneti, prandaj mos e shisni atë për asgjë tjetër përveç tij”.¹⁰⁰

Është e qartë se njerëzit e kësaj bote përpiqen t’i japin vlerë dhe çmim ‘mbeturinës’ së kësaj bote (dynjasë), ata janë të gatshëm ta shkëmbejnë vetveten, qenien e tyre, identitetin dhe personalitetin e tyre për gjëra kalimtare. Por Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i ndalon nga ky “shkëmbim”. Ai thotë: “Nëse doni të bëni një shkëmbim, pse ta shisni veten për këtë mbeturinë? Në vend të kësaj, bëjeni Xhenetin dhe adhurimin ndaj Allahut çmimin e vetes suaj. Prandaj, pika qendrore këtu është kjo: Vlera e njeriut qëndron tek adhurimi ndaj Allahut dhe përgatitja për Xhenetin. Sigurisht, ekziston edhe një pikë qendrore tjetër, që është dinjiteti njerëzor, e kuptuar në fjalën: “Vlera e vetme e vetes suaj është Xheneti”, e cila e përfshin dhe nënkupton këtë dinjitet”.¹⁰¹

100 “Nehxhul Belaga”, Urtësia 456.

101 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

Botëkuptimi i lirisë

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë se e drejta ka dy perspektiva:

1. “E drejta”, sipas këndvështrimit të terminologjisë kur’anore

Ai thotë: “E drejta (el hakk), në terminologjinë kur’anore, që ndoshta përmendet më shumë se 200 herë në Kur’an, çka është diçka shumë e jashtëzakonshme, ka një kuptim të thellë dhe të gjerë. Mund të përmbliidhet shkurtimisht në dy kuptime:

- kuptimi sipërfaqësor (i drejtpërdrejtë) dhe kuptimi si një sistem i organizuar dhe me qëllim.

Në shumë ajete të Kur’anit, Allahu thotë se e gjithë bota është krijuar mbi bazën e të drejtës:

﴿وَمَا خَلَقْنَاهُمْ إِلَّا بِالْحَقِّ﴾

“Nuk i krijuam ato veçse me të drejtë (me qëllim dhe urtësi)”.¹⁰²

﴿وَهُوَ الَّذِي خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ بِالْحَقِّ﴾

102 Sure “Dukhan”, ajeti 39.

“Ai është që krijoi qiejt dhe tokën me të drejtë”.¹⁰³

Pra, sistemi i krijimit, përfshirë edhe vetë njeriun në aspektin fizik, pa marrë ende parasysh lirinë e zgjedhjes, është një sistem i ndërtuar me qëllim, i lidhur, i ndërlidhur dhe që funksionon me rregull dhe objektiv.

Më tej, ai e shpjegon të njëjtën çështje edhe në fushën e legjislacionit hyjnor (ligjet e shpallura). Pasi përmendi disa ajete për krijimin, thotë:

﴿تَزِيلُ الْكَعْبُ بِالْحَقِّ﴾

“Ai e zbriti Librin me të drejtën”.¹⁰⁴

﴿أَرْسَلْنَاكَ بِالْحَقِّ بَشِيرًا وَنَذِيرًا﴾

“Ne të dërguam me të drejtën, si përgëzues dhe paralajmërues. Vërtet, të Dërguarit e Zotit tonë na kanë ardhur me të drejtën”.¹⁰⁵

﴿قَدْ جَاءَتْ رُسُلُ رَبِّنَا بِالْحَقِّ﴾

“Të dërguarit e Zotit tonë na kanë sjellë të vërtetën”.¹⁰⁶

103 Sure “El En’am”, ajeti 72.

104 Sure “El Bekare”, ajeti 176.

105 Sure “El Bekare”, ajeti 119.

106 Sure “El Bekare”, ajeti 53.

Pra, kjo e drejtë në krijim dhe ajo e drejtë në ligjësim janë të njëjta. Kjo do të thotë se bota e ligjësimit është plotësisht e përputhur me botën e krijimit, sipas urtësisë hyjnore, ndonëse vullneti i njeriut mund të shkatërrojë disa nga anët e saj. Por, pasi ajo është në përputhje me krijimin dhe drejtimi është drejtimi i së drejtës, çdo gjë që duhet të jetë, e kërkon urtësia e Allahut. Për këtë arsye, ajo lëvizje e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse do të triumfojë në fund mbi të gjitha veprimet e pjesshme, që largohen, braktisen ose largohen nga kjo udhë. Prandaj, është e mundur të ndodhin lloje të ndryshme shkeljesh. Kjo është bota e krijimit dhe ajo është bota e ligjësimit. Në këtë botë, ndër përbërësit kryesorë, është vullneti i njeriut; ndër përbërësit e ligjësimit, është liria e njeriut. Kjo është, pra, e drejta. Me këtë këndvështrim, ne e shohim çështjen e lirisë: ajo është liria e të drejtës përballë të kotës”.¹⁰⁷

2. Botëkuptimi i detyrimit

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Liria nuk është nga ato çështje që njeriu mund t’i braktisë sipas dëshirës, në këndvështrimin e Islamit. Liria është detyrim. Çdo njeri duhet të jetë i lirë, të lërë pas dore çdo shtypje që i bëhet dhe të refuzojë arrogancën. Duhet ta shohim lirinë si

107 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

një detyrim. Nuk është e drejtë të thuhet: ‘Shumë mirë, liria është diçka e mirë, por unë nuk e dua këtë të mirë’. Jo, kjo nuk është e saktë. Njeriu duhet të përpiqet për lirinë, qoftë kjo liria e tij apo e të tjerëve. Nuk duhet lejuar që dikush të mbetet në shtypje, poshtërim ose nën sundim.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thotë: “Mos u bëj skllav i tjetrit, kur Allahu të ka krijuar të lirë”.¹⁰⁸ Kur’ani thotë:

﴿وَمَا لَكُمْ لَا تُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالْمُسْتَضْعَفِينَ﴾

“E ç’keni që nuk luftoni në rrugën e Allahut dhe për të shtypurit”¹⁰⁹; që do të thotë se ju jeni të detyruar të siguron lirinë e të tjerëve, madje edhe me luftë. Kjo lidhet me diskutime të ndryshme”.¹¹⁰

Krahasimi i diskutimeve midis mendimeve perëndimore dhe atyre islame

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) shpjegon se çfarë e dallon pikëpamjen islame mbi lirinë: “Pas asaj që u bë e qartë më sipër, themi se themeli dhe thelbi i vizionit islam për lirinë buron nga teuhidi dhe nga ajo që nënkupton

108 “Nehxhul Belaga”, nga porosia e tij për Imam Hasanin (*Paqja qoftë mbi të!*).

109 Sure “En Nisa”, ajeti 75.

110 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

teuhidi: mohimin e çdo adhurimi tjetër përveç Allahut të Lartësuar. Vetë adhurimi i Allahut është thelbi i asaj që kërkon humanizmi i njeriut, sipas botëkuptimit të së drejtës, ashtu si e shpjegon Kur'ani, kur flet për vlerat. Ndërsa origjina e kërkit të lirisë në Evropë dhe Perëndim nisi nga refuzimi i fesë gjatë asaj që e quajten epoka e Rilindjes. Kështu, dallimi kryesor që e veçon vizionin islam nga të tjerët, është se Islami e vendos Zotin në qendër, përballë përqendrimit të njeriu, që bëri mendimi liberal.

Mendimi liberal u përpoq ta vendoste njeriun si boshtin kryesor në çdo diskutim mbi vlerat, ndërsa Islami e vendos teuhidin si themel dhe mbi të ndërton gjithë vlerat e tjera. Pasojat praktike të mendimit perëndimor tregojnë qartë dështimin e vizionit të tyre mbi lirinë, të cilën e ndërtuan prej shekujsh. Gjendja reale e shoqërisë perëndimore është shumë e keqe dhe e hidhur, madje e shëmtuar. Nuk ka drejtësi, asgjë të tillë; përkundrazi ka racizëm dhe tirani. Në fushën ndërkombëtare ndezin luftëra. Vetëm për të siguruar që fabrikat e armëve të fitojnë para, nxisin luftë mes dy popujve. Shkojnë në vendet e Gjirit Persik dhe i frikësojnë nga Irani e nga Republika Islamike, vetëm që t'u shesin avionë "Fantome" e "Mirage". Të tilla gjëra i bëjnë vazhdimisht. Për sa u përket parullave të larta si "të drejtat e njeriut" dhe "pavarësia popullore", i trajtojnë në mënyrë selektive dhe jo etike. Prandaj, gjendja aktuale e

jetës në Perëndim, në atë Perëndim ku filozofët folën kaq shumë për lirinë, në realitet është një gjendje e keqe.

Njeriu, kur i sheh këto teori, më pas i refuzon ato; kjo është një lloj qasjeje. Unë besoj se nuk duhet të mbështetemi në mënyrë absolute në këtë qasje. Po, këto realitete, në masë të madhe, tregojnë se ata mendimtarë që u larguan nga Zoti dhe u mjaftuan vetëm me veten, ranë në humbje dhe i humbën edhe popujt e tyre, duke u bërë banorë të Xhehenemit bashkë me ta. Nuk ka dyshim për këtë. Megjithatë, unë mendoj kështu: Rishikimi i mendimeve të mendimtarëve perëndimorë, përplasja e mendimeve mes tyre dhe ajo përparësi që kanë në organizimin e ideve dhe sistemimin e çështjeve, mund të jetë i dobishëm për mendimtarët tanë, me një kusht: që të mos ketë imitimin, sepse imitimi është kundër lirisë. Nuk duhet të ndodhë imitimi, por mënyra e punës së tyre mund të t’ju ndihmojë”.¹¹¹

111 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 13.11.2012.

SHPRESA

Hyrje

Pritja e çlirimit dhe e premtimit hyjnor është një nga bazat e planit islam për njerëzimin. Nuk mund të kuptohet feja islame pa kuptuar realitetin e premtimit hyjnor, sepse ky premtim përfaqëson qëllimin përfundimtar të botës.

Premtimi hyjnor shfaqet në domosdoshmërinë e shfaqjes së Imam Mehdiut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe në domosdoshmërinë e ngritjes së shtetit të drejtësisë dhe të tjera manifestime. Por, ajo që duhet theksuar, gjithashtu, është se besimi në këtë premtim nuk është thjesht një parullë politike apo një çështje kalimtare, por është një çështje që hyn thellë në vizionin kozmologjik dhe teologjik. Ajo është diçka me të cilën duhet të formohen zemrat dhe shpirtrat. Prej këtui, shpresa e vërtetë, është një nga shfaqjet e besimit në premtimin të pashmangshëm hyjnor, sepse shpresa është shprehje shpirtërore dhe zemërore e besimit në këtë premtim. E kush nuk ndien shpresë, atëherë frikësohet se besimi i tij në këtë premtim nuk ka kaluar përtej një pohimi me gjuhë.

Shfaqjet e shpresës

1. Pjesëmarrja e popullit nëpër sheshe

Islami nuk është fe individuale, në kuptimin e ngushtë, pra, në kuptimin që të merret vetëm me çështjet e individit, pa u marrë me çështjet e shoqërisë dhe të botës. Përkundrazi, të gjitha vlerat e tij kanë shfaqje dhe manifestime në nivele individuale, shoqërore dhe ndërkombëtare, duke filluar nga vlerat e adhurimit dhe lutjes e deri te vlerat e lëvizjes dhe të revolucionit.

Prandaj, ndihmesa e të vërtetës dhe e ithtarëve të saj kërkon një lëvizje shoqërore, që të jetë e mbushur me shpresë në premtimin hyjnor. Shfaqja kryesore e shpresës popullore është që kjo shpresë të bëhet një forcë lëvizëse për popujt, drejt qëllimeve të tyre të larta dhe synimeve hyjnore. Nga kjo perspektivë, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) e sheh pjesëmarrjen e popullit në fusha të ndryshme shoqërore, kulturore dhe politike si një nga shfaqjet e shpresës dhe të besimit. Ai thotë: “Faktori kryesor i fitores është prania e popullit në arenë dhe faktori që e realizon praninë e tyre në arenë, është shpresa dhe siguria. Kjo duhet forcuar tek ata dhe nuk duhet që njerëzit të kenë frikë, të dyshojnë dhe të humbin besimin. Ju e lexoni në Kur’an ajetin:

﴿الَّذِينَ قَالَ لَهُمُ النَّاسُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ﴾

“Ata të cilëve njerëzit u thanë: Njerëzit janë mbledhur kundër jush, prandaj kini frikë prej tyre...”¹¹² Kjo është nga ana e armikut, që thonë “kini frikë”. Në një ajet tjetër thuhet:

﴿إِنَّمَا ذَلِكَ الشَّيْطَانُ يَخَوْفُكُم لِيَأْخُذَ﴾

“Kjo është vetëm vepër e djallit që i frikëson miqtë e tij”.¹¹³

Po ashtu thotë:

﴿لَئِنْ لَمْ يَنْتَهِ الْمُشْرِكُونَ وَالَّذِينَ فِي قُلُوبِهِم مَّرَضٌ وَالْمُرْجُونَ فِي الْمَدِينَةِ لَتُفْرِكَنَّهُمْ﴾

“Nëse hipokritët dhe ata që kanë sëmundje në zemër dhe përhapësit e lajmeve të rreme në Medinë nuk ndalen, Ne do t’ju ngacmojmë ty kundër tyre”.¹¹⁴ Pra, frikësimi i njerëzve është i dënueshëm, po ashtu edhe shkurajimi dhe shqetësimi i tyre.

Në të kundërt, një ajet tjetër thotë:

﴿وَالْعَصْرِ ١ إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ ٢ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصُوا بِالحَقِّ وَتَوَّصُوا بِالصَّبْرِ﴾

“Pasha Kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besuan, bënë vepra të mira, u këshilluan

112 Sure “Al Imran”, ajeti 173.

113 Sure “Al Imran”, ajeti 175.

114 Sure “El Ahzab”, ajeti 60.

për të vërtetën dhe u këshilluan për durim".¹¹⁵ Kështu që, duhet të këshillojmë njëri-tjetrin për durim, qëndrueshmëri, ndjekjen e të vërtetës dhe ruajtjen e njëri-tjetrit.

Në një ajet tjetër, thuhet, gjithashtu:

﴿وَالْمُؤْمِنُونَ وَالْمُؤْمِنَاتُ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ﴾

"Besimtarët dhe besimtares janë miq e mbrojtës të njëri-tjetrit".¹¹⁶

Pra, aleatë janë ata që janë të lidhur me njëri-tjetrin. Kjo është përgjegjësia jonë. Për këtë arsye, duhet t'i kushtohet vëmendje kësaj pike që lidhet me shpresën dhe qetësinë shpirtërore".¹¹⁷

Ai, gjithashtu, thotë: "Ne duhet të bëjmë përpjekje dhe t'i ndryshojmë marrëdhëniet e gabuara që çojnë në prapambetjen e popujve, përfshirë popullin tonë. Duhet gjithashtu të kompensojmë rastet e prapambetjes së kaluar. E gjitha kjo ka nevojë për përpjekje, vendosmëri dhe shpresë. Nëse populli e humb shpresën për të ardhmen, ose i dobësohet vullneti për të hapur rrugët dhe për të ecur drejt objektivave, atëherë do të mbetet pas dhe nuk do të ecë

115 Sure "Asr".

116 Sure "Teube", ajeti 70.

117 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 16.09.2010.

përpara, dhe do të dominohet nga fuqitë sunduese botërore, duke humbur kështu dinjitetin e tij”.¹¹⁸

2. Thirrja drejt shpresës

Siç u përmend më herët, shpresa, si vlerë, nuk është një gjë e imagjinuar, e rastësishme apo thjesht një ndjenjë kalimtare, por, sipas sistemit teologjik islam, ajo buron nga besimi në realitetin e premtimit hyjnor. Shpresa ka një shtyllë mendore që duhet të forcohet dhe të nxirren në pah, qartë, në nivel teorik e më pas të ftohen hapur njerëzit drejt saj.

Prandaj, shohim se Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) i fton dijetarët dhe njerëzit e diturisë që ta përhapin idenë e shpresës. Kjo është një dëshmi e qartë se kjo vlerë nuk ka vetëm dimension emocional. Ai thotë: “Sigurimi i njerëzve dhe përhapja e shpresës ndër ta është përgjegjësi e të gjithëve ne, klerikëve, përgjegjësve dhe imamëve të xhumasë. Duhet ta përhapim shpresën dhe qetësinë te njerëzit, sepse, nëse ata humbin shpresën, humbasin edhe besimin te vetja dhe tronditen, e atje ndodh humbja e pashmangshme. Ajo që e ruan luftëtarin në fronte, është shpresa; ai duhet ta fitojë shpresën dhe të dijë se mund të

118 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 29.12.2010.

arrijë në brigjet e fitores. Duhet ta ruajmë gjallë këtë shpresë”.¹¹⁹

Ai, gjithashtu, thotë: “Imamët e xhamive, drejtuesit dhe kujdestarët e tyre duhet të tërheqin zemrat e pastra të të rinjve dhe të ndezin tek ata dëshirën. Pjesëmarrja e të rinjve dhe fryma mobilizuese duhet të bëjnë që atmosfera e xhamive të jetë e gjallë, e mbushur me aktivitet, me pritje për të ardhmen dhe e mbushur me shpresë”.¹²⁰

Kjo përgjegjësi nuk bie vetëm mbi dijetarët dhe predikuesit, por çdo njeri që ka energji dhe aftësi të veçantë duhet t’i vërë ato në shërbim të nxitjes së shoqërisë dhe thirrjes së saj drejt virtyteve morale si shpresa dhe të ngjashmet, duke e paralajmëruar për dëmet e dëshpërimit dhe të humbjes së besimit. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) u thotë poetëve: “Rregullat e moralit gjenden në fjalët dhe në sjelljen e imamëve. Le t’i zgjerojmë vlerat morale në shoqëri dhe t’i ftojme njerëzit drejt mirësisë, shpresës, bashkëpunimit, vëllazërisë, durimit, butësisë, falënderimit, bamirësisë, altruizmit dhe faljes. Le t’i paralajmërojmë për sjelljet e këqija, si: ngushtësia e mendjes, dëshpërimi, dyshimi i pabazë, ofendimi i tjetrit, smira, koprracia dhe vese të tjera të këqija. Një gjë e tillë mund të arrihet përmes

119 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 16.09.2010.

120 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 12.10.2010.

artit poetik shumë më mirë se me gjuhën e thjeshtë të prozës apo të këshillave”.¹²¹

3. Devotshmëria

Devotshmëria është vizioni, sjellja dhe morali me të cilin njeriu përballet me vështirësitë psikologjike dhe të jashtme. Kjo do të thotë se njeriu i devotshëm është ai që është i armatosur me vizion, sjellje dhe vlera që e bëjnë të kapërcejë vështirësitë, tundimet dhe të gjitha llojet e rreziqeve që mund ta bëjnë njeriun të rrëshqasë në vendet e zemërimit, epshit dhe pengesave të tjera.

Nga kjo pikëpamje, shpresa për të ardhmen dhe shpresa në premtimin hyjnor, madje edhe në çdo premtim që ndodhet në rrugën e premtimit më të madh, kërkon devotshmëri, sepse njeriu, pa devotshmëri, do t'i ekzagjerojë kënaqësitë dhe tundimet, dhe kështu do të kërkojë rehati dhe qetësi, duke mos pasur durim për përpjekjet që kërkojnë për të realizuar premtimin hyjnor dhe shpresat e tjera, pasi rezultatet e mëdha kërkojnë përpjekje të jashtëzakonshme.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Kujdesuni mirë që ne duhet të veprojmë me devotshmëri.

121 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 24.05.2011.

Devotshmëria është ajo që na fuqizon, është ajo që bën që të mos prekemi nga goditjet, është ajo që na jep shpresë për të vazhduar këtë rrugë deri në arritjen e objektivave përfundimtare”.¹²²

Shpresa dhe çështja e Palestinës

Çështjet vendimtare që përjeton umeti dhe që kërkojnë përpjekje, xhihad dhe luftë, duhet të shoqërohen me besimin në premtimin hyjnor, se Allahu i Lartësuar do të zhdukë të pavërtetën dhe do të vendosë të vërtetën. Ky besim është pikërisht ai që mbjell farën e shpresës te të gjitha lëvizjet revolucionare dhe rezistuese.

Në kohën tonë, çështja e Palestinës përbën shqetësimin kryesor të umetit. Shumë prej atyre që e morën përsipër këtë çështje në një periudhë të caktuar, pas një kohe u goditën nga dëshpërimi dhe humbja e shpresës dhe e lanë çështjen. Ndërsa ata që besojnë në premtimin hyjnor, nuk kanë vend për dëshpërim në zemrat e tyre. Nga kjo pikëpamje, shpresa është veçoria kryesore që duhet të ketë ai që ka marrë mbi supe çështjen palestineze nga këndvështrimi i Islamit.

122 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 04.05.2010.

Për këtë, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Zgjidhja e vetme për çështjen e Palestinës është rezistenca dhe lufta. Kjo është e vërtetë, por rezistenca dhe lufta varen nga ruajtja e moralit të popullit dhe ruajtja e shpresës të njerëzit, duke i mbajtur ata të pranishëm në arenë. Ky, sipas mendimit tim, është veprimi më i madh që duhet të kryejnë grupet palestineze, organizatat dhe luftëtarët palestinezë. Presioni që ushqehet aktualisht mbi Gazën, nga të dyja anët, qoftë nga armiku sionist apo nga ana tjetër, ka për qëllim largimin e njerëzve nga rezistenca. Presioni mbi njerëzit në Bregun Perëndimor, qoftë në formën e ndërtimit të kolonive, ose lidhur me çështjen e Jerusalemit, për të cilën kam folur apo vështirësitë e mëdha dhe muri ndarës e të tjera, të gjitha kanë për qëllim të largojnë masat nga rezistenca dhe t’i shtyjnë drejt dorëzimit. Kjo nuk duhet lejuar. Ju nuk duhet ta lejoni këtë. Duhet të ruhet shpresa te populli palestinez dhe te banorët e Gazës, ky popull i fortë dhe rezistues, që të dinë se veprimet e tyre do të japin rezultat. Kjo është një pikë që mendoj se ka një rëndësi të madhe”.¹²³

Për sa i përket lëvizjeve islame të ringjalljes, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) i sheh ato, gjithashtu, si manifestime që kërkojnë vëmendje dhe përhapjen e shpresës: “Lëvizja e ringjalljes islame po përparon dhe po thellohet më shumë çdo ditë. Këto kushte që japin shpresë

123 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 27.02.2010.

dhe sjellin lajm të mirë, nga njëra anë, duhet të na shtyjnë ne, popujt myslimanë, drejt një të ardhmeje të dëshiruar me besim më të madh se kurrë më parë; nga ana tjetër, ato duhet të na bëjnë më të vetëdijshëm dhe më të vëmendshëm se kurrë më parë përmes mësimeve dhe përvojave të tyre. Nuk ka dyshim se kjo fjalë publike bën që dijetarët e fesë, udhëheqësit politikë, intelektualët dhe të rinjtë të jenë më të angazhuar se të tjerët dhe i nxit të kërkojnë xhihad dhe udhëheqje”.

Roli i edukimit dhe mësimit në përhapjen e shpresës

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thekson në shumë fjalime të tij se arsimi nuk kufizohet vetëm në përhapjen e dijes dhe të mendimit, por një nga funksionet më të rëndësishme të tij është formimi i personalitetit njerëzor, i cili zotëron vlera dhe morale. Duke qenë se vlera e shpresës është, gjithashtu, një nga shtyllat kryesore të personalitetit të besimtarit, siç u shpjegua më parë, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thekson se arsimi ka përgjegjësinë për të mbjellë këtë shpirt te studentët, duke thënë: “Mësuesi ka mundësinë të edukojë të miturin ose fëmijën dhe ta bëjë atë një njeri të ditur dhe mendimtar, të pasur me shpirt kërkimi shkencor dhe të etur për studim dhe dijeni, ose ta bëjë atë një njeri sipërfaqësor, pa dëshirë për të thelluar dijen dhe kërkimin shkencor. Ai mund ta nxjerrë dhe ta paraqesë në

shoqëri si një njeri të ndershëm, të lavdërueshëm, të mirë dhe të pastër në zemër, ose përkundrazi mund ta bëjë atë një njeri të keq dhe të dëmshëm. Ai, gjithashtu, mund ta bëjë atë një njeri optimist, me besim në vetvete, të mbushur me shpresë dhe i dashur për punën dhe aktivitetin, ose, në të kundërt, mund ta bëjë një njeri të dëshpëruar, të humbur, të tërhequr dhe të izoluar”.¹²⁴

Imam Khamenei, gjithashtu, thotë: “Shoqëria ka nevojë për individë besimtarë, të motivuar, të duruar, optimistë, me shpresë, të kujdesshëm ndaj interesave publike dhe të etur për të arritur majat e përkryerjes individuale dhe shoqërore, për njerëz krijues, të kërkueshëm, kërkues dhe studentë të përparimit. Kush do ta krijojë këtë? Këtu del roli i mësuesit. Sistemi i edukimit dhe i mësimit është shumë i rëndësishëm dhe i ndjeshëm. Natyrisht, është folur shumë për çështjet e edukimit dhe rolin e mësuesve. Dhe ne sot nuk jemi në rrethana që të mjaftohemi me fjalë, por kemi nevojë për veprim”.¹²⁵

124 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 05.05.2010.

125 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 18.08.2010.

Roli i shpresës në Revolucionin Islamik

Nuk ka dyshim se revolucioni më i madh i kohës moderne është Revolucioni Islamik në Iran. Dhe nëse duam të përmendim arsytet që qëndronin pas kësaj fitoreje të madhe, si dhe pas suksesit të vazhdueshëm të Revolucionit Islamik, do të shohim se shpresa për fitore dhe shpresa për sundimin e të vërtetës ishte një element i rëndësishëm dhe efektiv. Populli, Imam Khomeini (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*), ishin të bindur për qëllimin e tyre. Për këtë arsye, shpresa shpërfaqej në lëvizjet dhe qëndrimin e tyre.

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Shpresa jonë për të ardhmen është e mbushur me lulëzim dhe përparim. Nuk shpresonim që do të arrinim këto arritje me kaq shpejtësi. Allahu i Lartësuar e bekoi këtë dhe të rinjtë tanë sot realizojnë punë në fushat shkencore dhe teknologjike, që për ne dhe për ata që planifikonin të ardhmen 15-25 vjet më parë, dukeshin të paarrtshme. Kjo rrit shpresën për të ardhmen. Shpresa jonë është shumë e madhe. Përvojat politike janë përvoja të suksesshme dhe kudo që i shqyrtojmë, gjejmë përvoja të suksesshme”.¹²⁶

Ai, gjithashtu, thotë: “Unë ju them: për sa kohë që ne, unë dhe ju, ecim me vendosmëri, nuk heqim sytë nga

126 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 24.05.2011.

qëllimi dhe lëvizim me shpresë, asnjë fuqi në botë nuk mund të na e mbyllë rrugën. Kjo ka pasur ndikimin më të madh në çeljen e farërave të shpresës në zemrat e myslimanëve dhe popujve myslimanë. Kur ndodh një revolucion, shumë njerëz në botë gëzohen dhe zakonisht masat e popujve në botë reagojnë kështu”.¹²⁷

Imam Khamenei, vazhdon fjalën e tij: “Fara e shpresës që u mboll në zemrat e popujve, u ujit, u rrit dhe prodhoi fryte, ka lindur nga qëndrueshmëria e popullit të Iranit. Po të ishte tërhequr populli i Iranit, po të kishim braktisur parullat tona, po të ishim përkulur para kërcënimeve, frikësimeve dhe presioneve të imperializmit global, këto lule shprese që u rritën në zemrat e popujve do të ishin zverdhur dhe do të ishin tharë. Qëndrueshmëria juaj është ajo që i lejoj këto fara shprese të rriteshin dhe kjo ndodhi me bekimet shpirtërore hyjnore që na erdhën përmes Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), përmes emrit të bekuar të Zahrës së pastër dhe emrit të bekuar të imam Mehdiut, dhe kujdesit të Allahut për ne”.

127 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 24.05.2011.

DURIMI DHE SUKSESI

Hyrje

Traditat fetare kanë theksuar rëndësinë e durimit. Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Durimi është çelësi i arritjes dhe suksezi është përfundimi i atij që bën durim”.¹²⁸ Ky hadith i bekuar tregon se, kushdo që dëshiron sukses në çështjet e ndryshme të jetës, duhet të armatoset me durim, sepse durimi e çon atë drejt arritjes së suksesit dhe fitores.

Nisur nga ky parim i madh islam, udhëheqësi ynë i nderuar, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) tregon për rëndësinë e durimit në jetën e njeriut, përballë fatkeqësive, sprovave dhe vështirësive. Midis të tjerash, thotë: “Njeriu, përderisa është në këtë botë, është i ekspozuar ndaj fatkeqësive e sprovave, përjeton vështirësi e sëmundje, përballat me dëme e padrejtësi nga njerëzit në marrëdhënie dhe është i ngarkuar me detyrimin për të kryer adhurimet dhe për të braktisur ndalesat dhe dëshirat e kota. E gjithë kjo është e rëndë për shpirtin, e hidhur për shijen e tij; shpirti e urren dhe largohet prej saj. Prandaj, njeriu ka nevojë për një

128 “Tuheful Ukuli”, El Harranij, f. 218.

forcë të qëndrueshme dhe një cilësi të ngulitur fort, me të cilën arrin ta përmbajë veten përballë këtyre çështjeve të vështira, të qëndrojë i edukuar ndaj tyre, të mos kundërshtojë caktimin hyjnor me anë të ankesave e të mos hakmerret ndaj atyre që e kanë lënduar. Kjo forcë ose ajo që del si rezultat i saj, domethënë përmbajtja e vetes përballë këtyre çështjeve dhe rezistenca ndaj tekave të saj, quhet durim. Është e qartë se besimi i plotë, madje edhe vetë bindja, mbetet gjallë falë durimit dhe zhduket me mungesën e tij. Për këtë arsye, durimi, në raport me besimin, është si koka ndaj trupit, siç është transmetuar në hadith”.¹²⁹

Duke treguar më tej për rëndësinë e durimit, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Të gjithë kanë nevojë për durim, madje edhe më të përkryerit prej njerëzve. Shembulli më i plotë i drejtësisë është Imami Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili në shumë situata ushtroi durim. Ju e shihni dhe e njihni historinë e jetës dhe sjelljen e tij, ku ai vetë thotë: ‘Durova, megjithëse në sy kisha gjemba dhe në fyt kish bar të hidhur’. Në një rast tjetër, ai duroi ndaj presioneve të kharixhijve në luftën e Sifinit dhe pranoi arbitrazhin. Prandaj, durimi është i domosdoshëm dhe i kërkuar në çdo kohë dhe rrethanë”.¹³⁰

129 Shih: Mazandarani, Mulla Muhamed Salih bin Ahmed, *Shpjegimi i "Usul al-Kafi"*, vëll. 8, f. 277, me komentet e Mirza Ebu'l Hasan She'arani, redaktuar dhe korrigjuar nga Sejid Ali Ashur, Botimet “Dar Ihjau Et Turath El Arabi”, Liban, Bejrut, 1421 h/2000 gregorian, Botimi i parë.

130 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 28.05.2018.

Durim - do të thotë të qëndrosh në fushë

Udhëheqësi i madh, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*), thekson se durimi nuk nënkupton arratisje, tërheqje apo rënie përballë fatkeqësive dhe sprovave, por përballje dhe qëndrueshmëri, do të thotë të qëndrosh në fushë; pra, durimi është qëndrueshmëri dhe drejtësi njëkohësisht. Ai thotë: “Durim: do të thotë të qëndrosh në fushë dhe të mos largohesh prej saj. Disa ikin nga fusha, disa të tjerë nuk dalin menjëherë, por shkëputen gradualisht prej saj. Ky nuk është durim. Durimi është qëndrueshmëri, të mbetesh në fushë dhe të tregosh vendosmëri. Durimi është të shohësh drejt objektivave dhe horizonteve të largëta”.¹³¹

Në një vend tjetër, ai thotë: “Durim: do të thotë qëndresë dhe rezistencë.

Durim: do të thotë të mos i ndryshojmë llogaritjet tona të sakta për shkak të mashtrimeve të armikut.

Durim: do të thotë ndjekja e objektivave që kemi vendosur për veten tonë. Durimi është ecja dhe vazhdimi me moral dhe shpirt të lartë”.¹³²

131 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 30.06.2018.

132 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 22.03.2020.

Durimi dhe suksemi i rrugëtimit

Duke u nisur nga kuptimi i durimit dhe thelbi i tij, që është të qëndrosh dhe të mos dorëzohesh, kuptohet se durimi e çon njeriun drejt suksesit në udhëtimin e tij xhihadist dhe shkencor në rrugën e Allahut të Madhëruar. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Çdo rrugëtim, që të arrijë suksesin, ka patjetër nevojë për durim. Në kohën e fillimit të Islamit, në ato dekada të para, kur gjendja ishte jashtëzakonisht e vështirë, sidomos në kohën e të Dërguarit të madh, ata duruan, qëndruan dhe rezistuan. Përfundimi ishte se, megjithëse kishte mangësi dhe ndodhën gabime që nuk përputheshin me mësimet e vërteta të Islamit, kulmi i qytetërimit njerëzor, në shekujt e tretë dhe të katërt pas hixhretit, i takoi umetit mysliman dhe vendeve islame. Kështu është puna: nëse bëjmë durim, horizontet e largëta do të jenë tonat. Nëse qëndroni sot, brezat e ardhshëm do të ngjiten në atë majë”.¹³³

Allahu është me durimtarët

Suksemi nuk arrihet veçse nën hijen e kujdesit hyjnor, i cili përfshin ata që bëjnë durim. Kjo bëhet e qartë përmes komentimit që Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) u bën disa ajeteve rreth durimit. Midis të tjerash, thotë: “Allahu i

133 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 30.06.2018.

Madhëruar ka vendosur në Kur'an disa kushte, që të jetë me robin e Tij besimtar; ndër to është edhe durimi, siç thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ﴾

“Vërtet, Allahu është me durimtarët”.¹³⁴

Dhe:

﴿وَاللَّهُ مَعَ الصَّابِرِينَ﴾.

“Allahu është me durimtarët”.¹³⁵

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) shton e thotë: “Sot, ne përballemi me një front të madh politik, financiar, ekonomik, ushtarak e të sigurisë. Të gjitha aparatet propagandistike në botë pothuajse punojnë kundër nesh dhe na luftojnë. Aparatet financiare që u përkasin sionistëve, Amerikës dhe arrogantëve punojnë kundër nesh. Të gjithë ata po veprojnë. Por ne, falënderimi i qoftë Allahut, qëndrojmë të palëkundur, dhe kjo qëndresë është prej bekimit të devotshmërisë dhe besimit”.¹³⁶

Prandaj, nuk ka fushë të jetës që të mos ketë nevojë për durim dhe për mbështetje tek ai (durimi), që njeriu të mund të arrijë fitoren dhe synimet që kërkon; sepse kushdo

134 Sure “El Bekare”, ajeti 153.

135 Sure “El Bekare”, ajeti 249.

136 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), m 15.03.2018.

që dobësohet shpejt në vendosmërinë e tij, do të mposhtet”.¹³⁷

Fushat e durimit

Fushat e durimit përballë njeriut janë të shumta. Me to ai forcon vendosmërinë, arrin suksesin në rrugëtimin e tij dhe realizon objektivat hyjnore të misionit të profetëve. Në këtë kuptim, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) ka treguar se edhe fushat e xhihadit janë të llojllojshme, ndër të cilat:

1- Përballë armiqve

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Allahu i Madhëruar i dha Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) një plan veprimi përballë armiqësive. Që në fillim të shpalljes, Allahu i Madhëruar e urdhëroi të Dërguarin e Tij për durim. Në suren “El Muddethir”, e cila është ndër të parat sure të shpalljes profetike, Ai thotë:

﴿وَلَا يَكُفَّكَ اللَّهُ﴾

137 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 21.07.2013.

“Bëj durim për hir të Zotit tënd”.¹³⁸

Në suren “El Muzzemmil”, e cila është, gjithashtu, ndër suret e para të Kur’anit, thuhet: ﴿وَأَصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَأْتِيكَ﴾

“Bëj durim ndaj asaj që ata thonë. Pra, kështu u përcaktua plani i veprimit”.¹³⁹

Mbi këtë bazë, është nxjerrë plani i veprimit”.¹⁴⁰

Gjithashtu, Allahu thotë:

﴿وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا لَا يَضُرُّكُمْ كَيْدُهُمْ شَيْئًا﴾

“Nëse bëni durim dhe keni devotshmëri, dredhia e tyre nuk do t’ju shkaktojë asnjë dëm”.¹⁴¹ Ky është një ligj dhe një rregull i krijimit. Durimi dhe devotshmëria e kthejnë këtë armik kokëfortë, që ngjan me një fuçi të shëmtuar urrejtjeje e armiqësie, edhe pse ka mbledhur rreth vetes të gjitha mjetet, në një të paaftë që nuk mund të kryejë asnjë marrëzi kundër jush. ‘Dredhia e tyre nuk do t’ju shkaktojë asnjë dëm’, por me një kusht: kushtin e durimit dhe devotshmërisë”.¹⁴²

138 Sure “Mudethir”, ajeti 7.

139 Sure “Muzemmil”, ajeti 10.

140 Nga fjalimi i Imam Khameneit (Allahu e ruajtë!), më 22.03.2020.

141 Sure “Al Imran”, ajeti 120.

142 Nga fjalimi i Imam Khameneit (Allahu e ruajtë!), më 30.06.2018.

Në një fjalë tjetër, Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) sqaron synimin kryesor të armiqve të fesë dhe Islamit, duke thënë: “Qëllimi që ndjekin armiqtë është ndezja e luftërave të brendshme midis myslimanëve. Për fat të keq, ata kanë arritur disi sukses në këtë, duke shkatërruar vendet islame njëri pas tjetrit, përfshirë Sirinë, Jemenin, Libinë dhe duke shkatërruar infrastrukturën e tyre. Pse? Pse duhet t’i dorëzohemi këtij komploti të fshehtë? Pse duhet të mbetet i paqartë, për ne, qëllimi i tyre? Duhet të kemi vizion dhe qartësi, nëse duam sukses dhe përparim në këtë rrugë”.

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Vini re! Këtë flamur nuk do ta mbajnë veçse ata që kanë vizion dhe durim”.¹⁴³ Prandaj, duhet të jemi prej njerëzve me vizion dhe prej atyre që bëjnë durim në këtë rrugë, siç thotë Allahu:

﴿وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا لَا يَضُرُّكُمْ كَيْدُهُمْ شَيْئًا﴾

“Nëse bëni durim dhe keni devotshmëri, dredhia e tyre nuk do t’ju shkaktojë asnjë dëm”.¹⁴⁴ Pra, nëse rrugëtimi ynë shoqërohet me vizion, durim dhe qëndrueshmëri, përpjekjet e tyre nuk do të japin frytë”.¹⁴⁵

143 Sejjid Rradij, *Nehxhu'l-Belaga*, burim i përmendur më herët, Hytbeja 173, f. 247.

144 Sure “Al Imran”, ajeti 120.

145 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 29.12.2015.

2- Përballë sprovave

Imam Khamenei (Allahu e ruajtë) thotë: “Një sëmundje si (pandemia e Koronavirusit) është shembull i këtij ajeti të bekuar:

﴿وَلَيَبْلُوَنَّكُمْ بِشَيْءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ وَالثَّمَرَاتِ﴾

“Ne do t’ju sprovajmë me diçka nga frika, uria, humbja e pasurisë, jetëve dhe të mirave”. Pandemia sjell frikë dhe realisht disa njerëz frikësohen; ajo, gjithashtu, shkakton krizë ekonomike dhe bëhet shkak për humbje të pasurisë, jetëve dhe prodhimeve. Por Allahu, më pas thotë: ﴿وَيَسِّرِ الصَّابِرِينَ﴾ -“Jepu lajmin e gëzuar durimtarëve”.¹⁴⁶ Pra, edhe këtu nevojitet durim, që do të thotë të veprohet drejt dhe me mendim të shëndoshë”.¹⁴⁷

3- Në pritje të çlirimit (shfaqjes së Imam Mehdiut)

Durimi paraqitet në formën e tij më të lartë, në pritjen e çlirimit nga Imam Mehdiu (*Paqja qoftë mbi të!*). Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Pritja e çlirimit nuk është padurim dhe caktim i një kohe të veçantë për shfaqjen; që njeriu të përcaktojë një kohë apo një datë të caktuar, duke

146 Sure “El Bekare”, ajeti 155.

147 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 22.03.2020.

thënë për shembull: kjo ngjarje duhet të përfundojë, kjo fatkeqësi duhet të marrë fund, ose Imami duhet të shfaqet. Atëherë njeriu humbet durimin, e godet tokën me këmbë nga ngulmimi dhe nxitimi. Kjo nuk është pritje e çlirimit. Pritja e çlirimit: do të thotë përgatitje dhe gatishmëri e brendshme. Padurimi dhe nxitimi janë prej gjërave të ndaluara. Ka një hadith që thotë: “Allahu nuk nxiton për shkak të ngutjes së robëve”.

Pra, nëse ti ngutësh dhe shpejton, kjo nuk do të thotë se Allahu duhet të marrë vendim sipas teje dhe të nxitojë bazuar në ngutjen tënde. Jo, çdo çështje ka kohën e vet të caktuar, ka afatin e vet, ka një urtësi, dhe ajo realizohet mbi bazën e asaj urtësie”.¹⁴⁸

4- Në punë

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thekson rëndësinë e durimit në punë dhe tregon se mungesa e durimit dhe nxitimi janë sëmundja e vërtetë e punës. Ai thotë: “Ndër të metat e punës janë mungesa e durimit dhe nxitimi. Kur njeriu këmbëngul me ngulm të madh: “Pse nuk ndodhi kjo? Pse nuk u arrit ajo?”, mund t’i themi se çdo gjë ka masën e vet, ka kohën e vet dhe afatin e vet, dhe nuk është e mundur që gjithçka të ndodhë shpejt. Një herë, një njeri erdhi tek

148 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 09.04.2020.

Imami Khomeini dhe iu ankua për gjendjen e qeverisë. Unë në atë kohë isha president i Republikës. Atëherë Imam Khomeini i tha vetëm një fjali, të cilën nuk e kam harruar kurrë: ‘O zotëri, drejtimi i një vendi është i vështirë’. Unë vetë isha president, por, kur Imam Khomeini e tha këtë fjalë, e besova me të vërtetë, nga thellësia e zemrës. Ka shumë punë që duhen kryer dhe duhet përgatitje dhe vendosmëri për to, por arritja e rezultateve ka nevojë për kohën dhe mundësitë e veta. Prandaj, nxitimi, ngutja dhe ndjenja e vonësës nuk janë ndjenja të mira”.¹⁴⁹

5- Në arritjen e qëllimeve të larta

E ardhmja e popujve dhe ringritja e atdheut arrihet nëpërmjet durimit, i cili i jep popullit shtysën dhe motivimin për të vazhduar, për t’u përballur me sfidat dhe për t’u përballur me armikun, si dhe e nxit atë të mendojë për zhvillim, përparim dhe lulëzim. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Ndryshimi nuk ndodh domosdoshmërisht menjëherë. Në disa raste, ndryshimi ndodh gradualisht. Prandaj, duhet shmangur ngutja dhe mungesa e durimit. Nëse qëllimi është përcaktuar dhe është shënjestruar drejt, dhe lëvizja është e vërtetë, nuk ka problem, nëse arrijmë me vonësë te qëllimi i ndryshimit. E rëndësishme është që të

149 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 14.03.2019.

përfundojmë rrugën dhe të ecim në drejtim të saj. Duhet të shmangim nxitimin dhe mungesën e durimit. Nuk është e vërtetë që të mendojmë se domosdoshmërisht duhet të kryejmë diçka menjëherë. Jo, nuk është kështu”.¹⁵⁰

Sipas mendimit tim, për të siguruar të ardhmen e vendit, kemi nevojë për durim dhe qëndrueshmëri. Këmbët tona duhet të jenë të forta dhe të palëkundura, ashtu siç thotë Kur’ani:

﴿رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَأَسْرِفَنَا فِي أَمْرِنَا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا﴾

“O Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe teprimet tona në punën tonë dhe forco këmbët tona”.¹⁵¹

Një nga gjërat që kërkohet në këtë lutje, është qëndrueshmëria e këmbëve. Durimi dhe qëndrueshmëria janë dy gjëra thelbësore. Veprimi xhihadist është shumë i domosdoshëm dhe çdo lloj hezitimi, pasigurie, nëse mundemi apo jo, nëse duhet të ecim përpara apo jo, janë gjëra shumë të dëmshme”.¹⁵²

150 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 03.06.2020.

151 Sure “Al Imran”, ajeti 147.

152 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 31.07.2020.

Një durim i mrekullueshëm, me begatinë e njohurive të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*)

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Nëse përçohet misioni i transmetimit të njohurive të Ehli Bejtit nëpërmjet mexhliseve të zisë, të tubimeve huseinije dhe ngjashëm, kjo do të jetë një thesar i pashtershëm. Ju e shihni sot, se vendi juaj dhe shoqëria juaj tregojnë një durim të mrekullueshëm nën presione të ndryshme. Kjo është me begatinë e njohurive të Ehli Bejtit, me bekimin e këtyre mexhliseve dhe tubimeve, me hirin e emrit të Hysenit, biri i Aliut dhe përmendjes së tij, si dhe me bekimin dhe përmendjen e emrit të Fatime Zehrasë”.¹⁵³

Pengesat e durimit

Pengesë kryesore përpara durimit është mëkati, sepse mëkati e pengon njeriun nga durimi, qëndrueshmëria dhe përballimi. Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Nëse njeriu sprovohet me një mëkat, ai mund të rrëshqasë e të dobësohet në një moment vendimtar e të ndjeshëm. Allahu i Madhëruar thotë në Librin e Tij:

﴿إِنَّ الَّذِينَ تَوَلَّوْا مِنْكُمْ يَوْمَ الْتَقَى الْجَمْعَانِ إِنَّمَا اسْتَزَلَّهُمُ الشَّيْطَانُ بِبَعْضِ مَا كَسَبُوا﴾

153 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 15.02.2020.

“Ata prej jush që u tërhoqën ditën kur u përplasën dy ushtritë, nuk ishte tjetër veçse Shejtani që i rrëshqiti për shkak të asaj që kishin fituar (mëkatet e tyre)”.¹⁵⁴

Në betejën e Uhudit, ata që nuk ishin të aftë të qëndronin me durim e qëndrueshmëri, zemrat e tyre filluan të lakmonin përfitimin e plaçkave dhe u treguan të pakujdesshëm ndaj detyrës madhore që kishin mbi supe. Ata e kthyen një luftë fitimtare në një luftë humbëse.

﴿وَأَسْرَأَهُمُ الشَّيْطَانُ بِبَعْضِ مَا كَسَبُوا﴾

“Shejtani i rrëshqiti për shkak të disa mëkateve që kishin bërë më herët, të cilat tani u shfaqën”. Pra, mëkatet tona bëjnë që të mos mund të tregojmë durim dhe rezistencë në një moment kritik e vendimtar”.¹⁵⁵

Këshilla ime për ju

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) na këshillon: “Bëhuni shembull i fjalës së Allahut:

﴿وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ﴾

154 Sure “Al Imran”, ajeti 100.

155 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 14.06.2016.

“Dhe këshillohuni me të vërtetën dhe këshillohuni me durimin”.¹⁵⁶ Ruajeni njëri-tjetrin, ashtu si alpinistët në zonat e rrezikshme, që lidhin trupat e tyre me litar, që të mos bjerë poshtë ai që i rrëshqet këmba, sepse janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe kanë shtrënguar veten me litar. Nëse rrëshqet njëri, të tjerët që nuk kanë rrëshqitur, e mbajnë dhe e ngrenë lart. Kështu është këshillimi dhe lidhja e ndërsjellë. ﴿وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ﴾ – këshillohuni për të vazhduar rrugën e të vërtetës nga njëra anë dhe me durim, nga ana tjetër. Durimi është qëndrueshmëri, rezistencë, forcë, përparim, guxim dhe vendosmëri përballë ngjarjeve të dhimbshme”.¹⁵⁷

Imam Khamenei (*Allahu e ruajtë!*) thotë: “Unë e këshilloj popullin me durim, dhe gjithashtu i këshilloj me respekt përgjegjësit e nderuar me durim dhe butësi. Nuk duhet të presim që problemet që rëndojnë jetën e njerëzve, qofshin ato në aspektin ekonomik apo të tjera, të zhduken brenda një periudhe të shkurtër.”¹⁵⁸

156 Sure “Asr”, ajeti 3.

157 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 20.04.2016.

158 Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu e ruajtë!*), më 03.08.2013.

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
UNITETI ISLAM.....	7
Hyrje.....	7
Kuptimi i unitetit islam	8
Uniteti islam përballë komplotit të armikut.....	12
Uniteti islam nuk është një parullë boshe.....	14
Revolucioni në Iran është një revolucion islam, jo një revolucion shi'it	15
Qendra bashkuese e myslimanëve	16
Uniteti islam: hapi i parë drejt krenarisë islame.....	19
DIJA.....	22
Vlera e dijes dhe e mendimit në strukturën e qytetërimit	22
Lidhja e dijes me disa vlera.....	24
1- Lidhja e vlerës së dijes me lirinë dhe drejtësinë	24
2- Lidhja midis dijes dhe fuqisë.....	25
Dija: masa e vetëbesimit	27

Ndërlidhja e vlerës së dijes me degët e tjera të ndërtimit të shoqërisë	29
Hapi i parë për të rrënjosur vlerën e dijes në shoqëri	30
Roli i mësuesit në përhapjen e vlerës së dijes.....	31
Dallimi mes përvetësimit të dijes dhe prodhimit të saj .	33
Përkushtimi ndaj dijes përbën në vetvete një xhihad	35
Respektimi i përparësive shkencore	36
Detyra e universitetit ndaj studentëve	37
1. Kujdesi për edukimin e studentëve	37
2. Edukimi i studentëve për t'i përgatitur ata për udhëheqjen e shoqërisë (në moral, kulturë dhe identitet)	37
a- Edukimi i studentëve mbi moralin e jetës islame...	40
b- Edukimi mbi moralin e marrëdhënieve shoqërore	41
c- Krijimi i kushteve për zhvillim dhe ngritje shpirtërore	42
Ai i tha: “Ti je skllavi i skllëvërve të mi, si të ngrihem për ty?!”	42
DREJTËSIA SHOQËRORE.....	44
Rëndësia e studimit të vlerave	44
Llojet e drejtësisë në Islam	46

Domosdoshmëria e origjinalitetit në kërkimin teorik mbi drejtësinë shoqërore	49
Adhurimi: qëllimi përfundimtar i drejtësisë në fe.....	50
Jeta dhe qëndrimi i profetëve ndaj të shtypurve	52
Drejtësia dhe fundi i botës	55
Shkalla e vlerave dhe drejtësia	56
Burimi i vlerës së drejtësisë në Islam.....	57
Lidhja e vlerës së drejtësisë me botëkuptimin (rendin kozmik)	59
Dy propozime për forcimin teorik të studimit mbi drejtësinë.....	60
RINIA	63
Rëndësia e rinisë	63
Disa këshilla për të rinjtë	64
1- Aspektet e ndërtimit të personalitetit të rinisë.....	64
2- Ndërtimi i vetes, në nivel individual dhe shoqëror	65
3- Forcimi i themeleve njohëse dhe shmangia e turbullirës dhe largimit.....	66
4- Vazhdimi i kërkimit të vlerave ideale dhe llogaridhënies.....	68
5- Kritika, së bashku me propozimin dhe shmangia e talljes	69

6- Përfitimi nga njerëzit me përvojë.....	70
7- Kontrolli i ndjenjave.....	71
8- Rëndësia e krijimit të diskursit.....	71
9- Kujdesi dhe vigjilenca ndaj përpjekjeve të armikut për t'ju rekrutuar.....	72
10- Të vepruarit me sinqeritet.....	74
Rekomandime për përgjegjësit, lidhur me rininë.....	75
1- Drejtimi kah të rinjtë dhe këshillimi i tyre.....	75
2- Kujdesi ndaj elitave të reja	76
3- Transformimi në vështtrimin ndaj brezit të ri dhe besimi tek ai.....	77
4- Dështimi i planeve të armikut për dobësimin e moralit të njerëzve	77
5- Kujdesi për çështjet e edukimit moral dhe bukurinë shpirtërore të të rinjve.....	78
6- Vlerësimi i energjisë së të rinjve dhe shfrytëzimi i tyre	80
Lutja ime për të rinjtë.....	81
LIRIA.....	83
Hyrje.....	83
Elementet e kërkimit rreth lirisë.....	86
1. Tema e lirisë.....	86

2- Liria në Islam	87
Botëkuptimi i lirisë	94
1. “E drejta”, sipas këndvështrimit të terminologjisë kur’anore.....	94
2. Botëkuptimi i detyrimit	96
SHPRESA	100
Hyrje.....	100
Shfaqjet e shpresës.....	101
1. Pjesëmarrja e popullit nëpër sheshe.....	101
2. Thirrja drejt shpresës.....	104
3. Devotshmëria	106
Shpresa dhe çështja e Palestinës.....	107
Roli i edukimit dhe mësimit në përhapjen e shpresës .	109
Roli i shpresës në Revolucionin Islamik	111
DURIMI DHE SUKSESI	113
Hyrje.....	113
Durim - do të thotë të qëndrosh në fushë.....	115
Durimi dhe suksesi i rrugëtimit	116
Allahu është me durimtarët.....	116
Fushat e durimit	118
1- Përballë armiqve.....	118

2- Përballë sprovave	121
4- Në punë.....	122
5- Në arritjen e qëllimeve të larta	123
Një durim i mrekullueshëm, me begatinë e njohurive të Ehli Bejtit (<i>Paqja qoftë mbi ta!</i>)	125
Pengesat e durimit.....	125
Këshilla ime për ju.....	126

اسم الكتاب: دروس من فكر الامام اخلاصني 2

(الوحدة الإسلامية، العلم، العدالة الاجتماعية، الشباب، الحرية، الأمل، الصبر و النجاح)

الاعداد: مركز المعارف للتأليف والتحقيق

المترجم: الشيخ ولنت (عباس) مزيّا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: إسراء مزيّا

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغالف: صبريه فزا

الناشر: جمعية النسيم، تيرانا- البانيا - 2025